



Analiza:

MODERNIZIMI I LIBRAVE TË HISTORISË

Projekt:

**Interpretimi i historisë së përbashkët
së kohës bashkëkohore**

Analiza:

Modernizimi i librave të historisë

**Мировна акција/Аксioni Пақёсор
Асоциациони и Мёсимдхёнёсве тё Историсё тё Мақедонисё**

Analiza:
Modernizimi i librave të historisë

Ekipi i redaktorëve:
Marina Gjorgjioska-Kitanoska (Aksioni Paqësor)
Mire Mlladenovski (Asociacioni i Mësimdhënësve të Historisë të Maqedonisë)

Ekspertë të cilët morën pjesë në krijimin e analizës si autorë:
Prof. dr. Katerina Todoroska
Doc. dr. Zejni Mazllami

Ekipi i trajnerëve dhe udhëheqësve të takimeve të dialogut:
Mire Mlladenovski
Emrah Rexhepi
Boro Kitanoski
Goran Taleski

Kuadri i Mësimdhënësve të historisë të shkollave fillore dhe të mesme të cilët dhanë kontribut të jashtëzakonshëm dhe të pakursyer:

Natasha Matakova – SHFK “Dobri Daskallov”, Kavadar	Irena Mlladenovska – SHFK “Mirçe Acev”, Shkup
Dijana Rubellova – SHMK “Dimitar Vllahov”, Strumicë	Lupka Hristova – SHF “Joakim Kërçovski”, Shkup
Anita Zafirovska – SHFK “Goce Dellçev”, Kumanovë	Zdravko Stojkoski – IK Muzeu i Maqedonisë
Kenan Iseni – SHM “Dr. Pançe Karagjozov”, Shkup	Merjem Emini – SHF “Liria”, Tetovë
Valentina Stamenkoviq – SHM “Dr. Pançe Karagjozov”, Shkup	Harun Rexhepi – SHF “Migjeni/Bratstvo”, Tetovë
Dragan Trajçev – SHF “Rade Kratoçev”, Koçan	Ivana Nastovska – SHFK “Dobre Jovanoski”, Prilep
Nikolla Tollomanoski – SHFK “Riste Risteski Riçko”, Prilep	Frosina Avramoska – SHFK “Kliment Ohridski”, Prilep
Vesna Barkova – SHFK “Panko Brashnarov”, Veles	Ana Micevska – SHF “Vëllezërit Milladinov”, f. Dobrushevë
Mire Mlladenovski – SHFK “Tihomir Milloshevski” - Shkup	Dragan Dimov – SHF “Aleksandar Turunxhev”, Manastir, f. Kukureçan
	Muzafer Saliu – SHMK “Gostivar”, Gostivar

Botues:
**Aksioni Paqësor dhe Asociacioni i
Mësimdhënësve të Historisë të Maqedonisë**

Lektura:
**Julijana Taleska
Ilir Ajdini**

Përkthimi në shqip:
Kreshnik Ajdini

Dizajni:
Aleksandar Dudeski

2021

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Aksionit Paqësor dhe AMHM-së dhe në asnjë mënyrë s'mund të konsiderohet se i shpreh pikëpamjet e Civica Mobilitas, Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) apo organizatave që e realizojnë.

Përmbajtja

Parathënie	8
Hyrje	11
Metodologjia	18
Studim i përgjithshëm i nevojave për ndryshimin e librave të historisë – takime dialogu me kuadrin arsimor të historisë	19
Rekomandime të projektit	19
Cilat janë mesazhet të cilat dëshirojmë t'i dërgojmë si historianë?	25
Puna me fokus-grupe për nevojat e analizës me prof. dr. Katerina Todoroska dhe doc. dr. Zejni Mazllami	26
Puna me nxënës dhe punonjës shkencorë – analizë e librave	26
Takime me nxënës dhe nxënës të arsimit fillor	26
Takime me nxënës dhe nxënës të arsimit të mesëm	27
Realizimi i pyetësorit për kuadrin arsimor të përfshirë në këtë projekt dhe kuadrin arsimor të cilët nuk janë përfshirë në këtë projekt	28
Takim me kuadrin mësimdhënës	29
Rekomandime nga prof. dr. Katerina Todoroska dhe doc. dr. Zejni Mazllami	30
Konkluzione nga prof. dr. Katerina Todoroska dhe doc. dr. Zejni Mazllami	33
Për organizatat	36
Мировна акција / Aksioni Paqësor	36
Asociacioni i Mësimdhënësve të Historisë të Maqedonisë	38
Për projektin	40
Biografite	41
Bashkautorë	41
Ekipi i trajnerëve	44
Aneks 1	48
Studim i gabimeve të caktuara në librat e historisë të arsimit fillor dhe të mesëm. Prof. dr. Katerina Todoroska dhe doc. dr. Zejni Mazllami	46
Librat e arsimit fillor	46
Librat e arsimit të mesëm	49
Aneks 2	53
Pyetësori për projektin “Interpretimi i historisë së përbashkët të kohës bashkëkohore”	53

Parathënie

Projektin “Interpretimi i historisë së përbashkët të kohës bashkëkohore” e krijuam para pandemisë së COVID-19, me qëllim që të fillojmë një proces të krijimit të rekomandimeve për përmirësimin dhe ndryshimin e librave të lëndës së historisë. Gjithsesi, ky proces vetvetiu nuk do të ishte i mundur dhe i filluar, sikur të mos e kishim përkrahjen serioze të kuadrit arsimor të historisë, i cili u përfshi në këtë projekt.

Gjatë realizimit, krahas pandemisë së COVID-19, u ballafaquam me disa sfida: në shtator 2020 shkollat filluan me realizimin e mësimit në distancë, në nëntor 2020 R. e Bullgarisë i vuri veto vendit për fillimin e negociatave me Bashkimin Evropian dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës filloi një proces të reformimit në arsim, i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë ka implikacione në lëndën e historisë. Procesi i reformës filloi në periudhën nëntor-dhjetor 2020 dhe hasi në reaksione nga ana e kuadrit arsimor. Këto sfida gjithsesi ndikuan në punën tonë, por në një mënyrë të hapur dhe konstruktive. Aksioni Paqësor dhe AAHM i vendosën këto sfida si pika të rëndësishme për hapjen e diskutimit dhe dialogut, kështu që kuadri arsimor i cili ishte përfshirë në këtë projekt ushtronte të bisedojë për atë se si këto

politika dhe rrjedha shoqërore kanë ndikim në klasat mësimore dhe në shkollat.

Për qëllimin e këtij publikimi, i cili paraqet hapje të një procesi për rekomandimet për atë se si një libër bashkëkohor i historisë në shekullin XXI do të duhej të duket, duam të theksojmë disa çështje kyçe:

- Është fakt se programet dhe librat e historisë për arsim fillor dhe të mesëm nuk janë reformuar që nga viti 2005 – që nuk është rasti me lëndët e tjera në arsim;
- Kuadri arsimor i lëndës së historisë ka ardhur në përfundim se plani mësimor i historisë promovon ndarje etnike, se është binacional dhe me vetë këtë ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi librat dhe procesin mësimor dhe nuk promovon unitet, edhe pse Republika e Maqedonisë së Veriut është deklaruar si një shtet multi-etnik;
- Segregacioni etnik në shkolla është fuqishëm i pranishëm;
- Ekziston një hapësirë e dukshme e hapur për përmirësimin e komunikimit ndërmjet kuadrit arsimor nëpërmjet këmbimeve profesionale, bashkëpunimit dhe ndërtimit të kapaciteteve.

Të prirë nga këto perceptime dhe përgjithësisht nga gjendja në arsim kur bëhet fjalë për lëndën e historisë, Aksioni Paqësor dhe AMHM krijuan një partneritet strategjik për punë afatgjatë në proceset lidhur me sfidat e lartpërmendura.

Qëllimi ynë afatgjatë është: Krijimi i partneritetit për ndërtimin e paqes dhe mirëkuptimit të ndërsjellë në arsim, ndërsa me këtë projekt kemi për qëllim të krijojmë: kapacitete të përforcuara të kuadrit arsimor të historisë nga shkollat fillore dhe të mesme në Republikën e Maqedonisë së Veriut për një qasje kritike të narrativave etnocentrikë historikë dhe avancimin e mënyrave në të cilat realizohen orët e historisë.

Hapat për krijimin e rekomandimeve u zhvilluan në etapa, në disa faza. Në gjysmën e parë të realizimit të këtij projekti, realizuam trajnim për përpunimin kontekstual dhe ndërtimin e një grupi dhe tri takime dialogu me një grup prej 18 mësimitdhënësve dhe mësimitdhënësve të historisë nga vendi. Trajnerë në këto trajnime ishin: Mire Mlladenovski, Goran Taleski, Emrah Rexhepi dhe Boro Kitanoski.

Nga janari 2021 e filluam edhe procesin e identifikimit dhe zgjedhjes së historianëve akademikë të cilët do t'i japin mendimet e veta në lidhje me nevojat për ndryshim dhe përmirësim të librave të historisë. Për këtë qëllim,

Aksioni Paqësor dhe AMHM e filluan bashkëpunimin me prof. dr. Katerina Todoroskan dhe doc. dr. Zejni Mazllamin. Një pjesë e botëkuptimeve të tyre u inkadruan në këtë publikacion.¹

Duhet të theksojmë se analiza e librave është një punë komplekse, si nga aspekti i identifikimit të gabimeve në librat, të cilat ndodhin nga ato teknike/drejtskrimore deri te ato kontekstuale dhe didaktike, ashtu edhe nga aspekti i krijimit të rekomandimeve për libra të rinj dhe bashkëkohorë të cilët do t'i ndjekin rrjedhat e arsimit bashkëkohor.

Me këtë projekt filluam me perceptimet fillestare të thelluara për për nevojat për ndryshimin e librave shkollorë. Në këtë drejtim, u përpoqëm t'i përcaktojmë mangësitë në libra dhe në program me ndihmën nga mësimitdhënësit dhe mësimitdhënëset e përkushtuara të shkollës fillore dhe të mesme, ndërsa gjithashtu fituam një pasqyrë edhe nga profesorët e institucioneve të larta arsimore, të cilët i shprehën brengat dhe qëndrimet e tyre për gabimet të cilat mbisundojnë në librat shkollorë.

Ky proces na solli edhe perceptime të shumta. Së pari, se ndryshimi dhe përmirësimi i

1. Punimi i tërë është dorëzuar tek Aksioni Paqësor dhe AAHM dhe është në dispozicion me kërkesë.

librave shkollorë është një proces afatgjatë i cili kërkon një debat më të gjerë dhe konsensus rreth drejtimit në të cilin dëshirohet të shkohet, qëllimeve të cilat pritet të arrihen, mënyrës së koncipimit të librave shkollorë, si dhe për periudhën kohore e cila është e nevojshme për të arritur deri te një libër shkollor që është i pranueshëm për të gjithë dhe një libër shkollor i koncipuar në mënyrë bashkëkohore, i cili do t'i kënaqte nevojat e nxënësve, si dhe të shoqërisë në tërësi. Reformat e shpejtuara, edhe me qëllimet më të mira, në rast se nuk janë një proces i gjallë i cili u nënshtrohet ndryshimeve të vazhdueshme sipas nevojave, nuk do të japin fruit. Kuadri arsimor është shtylla mbi të cilin duhet të mbështetet reforma në arsim dhe inkuadrimi i tij në këtë proces është një nevojë e domosdoshme.

Në këtë publikim, Aksioni Paqësor dhe AMHM theksojnë rekomandimet për ndryshim të librave shkollorë të cilët do ta

promovojnë multikulturalizmin, ndërtimin e paqes dhe përbashkësisë, qasjen kritike ndaj ngjarjeve historike, ndërsa prof. dr. Todoroska dhe doc. dr. Mazllami paraqesin raste me lëshime dhe gabime në librat shkollorë me të cilët ballafaqohen nxënësit. Që të dy profesorët japin rekomandime dhe konkluzione si rezultat i analizës së tyre të librave shkollorë, të bazuara edhe në takimet me punonjësit shkencorë, mësimdhënësit dhe nxënësit.

Në këtë pjesë na mbetet t'i falënderojmë grupit të mësimdhënësve dhe mësimdhënëseve, të cilët punuan me përkushtim me ne në këtë projekt, ndërsa strategjikisht i shohim si bashkëpunëtorë afatgjatë.

Ky projekt është i përkrahur nga programi i Civica Mobilitas.

Realizimi është nga qershori 2020, deri në maj 2021.

Mire Milladenoski

Kryetar i Asociacionit të Mësimdhënësve të Historisë të Maqedonisë

Marina Gjorgjioska-Kitanoska

Punëtoressë paqësore dhe koordinatore e projektit nga Мировна акција/Aksioni Paqësor

Hyrje

Marrëdhëniet ndëretnike në arsim i takojmë në dokumente të shumta nacionale, më saktë, në strategji: Koncepti i Arsimit Interkulturore i vitit 2015², Strategjia për Arsim 2018-2025 dhe Plani Aksional³, i miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH), Plani Strategjik i MASH-it 2020-2022 dhe Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Konceptit për Një Shoqëri dhe Interkulturalizëm e Republikës së Maqedonisë së Veriut⁴, e miratuar nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe dokumente/raporte të shumta të përgatitura nga ana e sektorit qytetar.

Të gjitha këto dokumente vënë theksin mbi integrimin ndëretnik në arsimin fillor dhe të mesëm, përmirësimin e përmbajtjes së arsimit fillor dhe të mesëm, si dhe përmirësimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore në shkollat fillore dhe të mesme. Gjithashtu, sfidat në këto dokumente janë shumë të ngjashme, më saktë, është identifikuar segregacioni etnik në shkolla, cilësia e pamjaftueshme e komunikimit dhe mësimin për “të tjerët”.

Nëpërmjet analizës së bërë për këtë projekt, identifikuam selënda e historisë nuk është përfshirë

në prioritetet strategjike të institucioneve kur bëhet fjalë për integrimin ndëretnik. Gjithashtu, një pjesë e problemeve të cilat i identifikuam, ndërsa do t'i përfshijmë me këtë aksion, janë se kurikula për lëndën e historisë nuk është ndryshuar që nga viti 2005, gjë që nuk është rasti me lëndët e tjera. Kjo kurikul, vetvetiu promovon ndarje etnike dhe në vendosjen e vet është binacionale dhe kjo qasje reflektohet në librat shkollorë të historisë, ndërsa me vetë këtë edhe në arsim, edhe pse Republika e Maqedonisë së Veriut deklarohet si shtet multi-etnik dhe multikulturore.

Në mars të vitit 2021, Ministria e Arsimit dhe Shkencës e hartoi konceptin për arsimin fillor⁵. Ky koncept jep një pasqyrë të qartë dhe kahe për atë se në çfarë drejtimi do të shkojnë reformat në arsimin fillor.

Duke i ndjekur përcaktimet strategjike të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe me këtë edhe reformat në rrjedhë e sipër të cilat i parasheh vetë

2. <http://www.mon.gov.mk/images/Koncepti-ja-mk.pdf>

3. <http://www.mon.gov.mk/index.php/dokumenti/strateshki-plan>

4. <https://vlada.mk/node/19447?ln=mk>

5. <https://mon.gov.mk/content/?id=3785>

koncepti, vlerësojmë se kjo iniciativë e jona me këtë projekt është komplementare me qasjet strategjike të MASH-it.

Kështu, sipas konceptit për arsimin fillor, i cili e citon Ligjin për arsim fillor, është përcaktuar se e drejta për arsim të çdo fëmije i përcakton parimet mbi bazat e të cilave zhvillohet arsimi fillor: interesi më i mirë dhe zhvillimi i tërësishëm i nxënësit; barazia, disponueshmëria, qasja dhe inkluziviteti; karakteri i arsimit të përgjithshëm të arsimit fillor; siguri i arsimit cilësor dhe krahasueshmëria ndërkombëtare e diturisë së nxënësve; pjesëmarrja aktive e nxënësve në jetën e shkollës dhe bashkësisë; përgatitja e nxënësit për mësim të përjetshëm; pranimi i dallimeve, multikulturalizmi dhe interkulturalizmi; përkujdesja për sigurinë fizike dhe shëndetin; autonomi, kompetencë dhe përgjegjësi dhe partneritetet mes shkollave, prindërve, gjegjësisht përkujdesësve dhe njësisve të vetadministrimit lokal. Ligji e thekson mbrojtjen nga diskriminimi dhe promovimin e barazisë, si dhe karakterin inkluziv të arsimit fillor.

Gjithsesi, në këtë drejtim do të theksojmë se interesi i Aksionit Paqësor dhe AAHM-së është edhe reforma në arsimin e mesëm, për lëndën e historisë, si në arsimin gjimnazor, ashtu edhe në atë të orientuar, profesional.

Iniciativat dhe hulumtimet e deritashme për ndryshime dhe nevojat për mësimin e lëndës së historisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Asociacioni i Mësimdhënësve të Historisë në Maqedoni (AMHM) në mënyrë aktive punon në fushën e avancimit të lëndës së historisë, në mënyrën në të cilën ligjërohet në klasë dhe, para së gjithash, në përfshirjen e kuadrit arsimor në krijimin e rekomandimeve për ndryshime të mundshme në sistemin e mësimin të historisë.

Në vitet 2011-2012, AMHM mori pjesë në projektin „A key to Unlock the Past“, së bashku me EUROKLIO (Asociacioni Evropian i Edukatorëve të Historisë), kur u hartua një publikim i cili paraqet një skanim të përgjithshëm të procesit të krijimit dhe publikimit të librave shkollorë të historisë. Kjo analizë është bërë me kërkesë të ministrit të atëhershëm të arsimit dhe shkencës, z. Pançe Krlev, në vitin 2011.

Edhe krahas analizës së bërë, ndryshime në librat shkollorë të historisë nuk janë bërë në periudhën pas vitit 2012. Duket

6. A Key to Unlock The Past – History education in Macedonia: An Analyses od today's suggestions for the future - Joke van der Leeuw-Roord, EUROCLIO – European Association of History Educators, The Hague/Skopje, 2012.

se rekomandimet fare nuk u morën në konsideratë gjatë krijimit të ardhshëm të politikave për lëndën e historisë.

Analiza është në dispozicion dhe në mënyrë shumë detajore e përpunon procesin e mësimi të historisë nga studimet deridiplomike, deri te ligjërimi i lëndës dhe përsosja e kuadrit arsimor nëpërmjet mësimi të vazhdueshëm.

Konkluzionet të cilat i veçuam nga analiza “A Key to Unlock the Past” janë relevante edhe sot e kësaj dite dhe me këtë qëllim do të përpiqemi të bëjmë një lidhje me konceptin e MASH-it dhe iniciativën e projektit për ndryshim, sendërtim dhe përmirësim të librave shkollorë të historisë për arsimin fillor dhe të mesëm.

Librat shkollorë të historisë, analiza e vitit 2012 - ndërlidhje

Koncepti për arsimin fillor i MASH-it përpunon standarde nacionale në tetë fusha. Për nevojat e këtij projekti, ne do të ndalemi te fusha e gjashtë, me të cilën edhe ndërlidhemi, Shoqëri dhe kulturë demokratike. Këtu bëjnë pjesë kompetencat që kanë të bëjnë me njohjen dhe kuptimin e vetvetes, me shoqërinë, historinë dhe organizimin e saj, për konceptet, strukturat

dhe lëvizjet ekonomike dhe politike, si dhe për shkathtësitë dhe qëndrimet të cilat duhet të mundësojnë që nxënësi të sillet në mënyrë demokratike dhe të përgjegjshme në shkollë dhe në të ardhmen të jetë një qytetar i përgjegjshëm dhe të marrë pjesë në mënyrë të motivuar dhe aktive në jetën shoqërore dhe qytetare.

Jemi të mendimit se vërejtjet në vijim për librat shkollorë të historisë duhet të merren në konsideratë gjatë reformës së lëndës së historisë:⁷

- Librat shkollorë të historisë kanë një përmirësim të ngadalshëm sa i përket dizajnit dhe cilësisë teknike. Ekziston mundësia për zgjedhjen e asaj se cili libër shkollor do të shfrytëzohet. Krahas librave shkollor, kemi mungesë të burimeve cilësore, të cilat do të shfrytëzohen për realizimin e arsimit aktiv dhe përfshirjen e nxënësve, me qëllim që ta mësojnë dhe ta kuptojnë historinë. Materiale të autorizuara digjitale për lëndën e historisë të dedikuara për kuadrin arsimor dhe për nxënësit nuk janë në dispozicion, as në gjuhën maqedonase, as në gjuhën shqipe.

- Procedurat për shkrimin dhe publikimin e librave shkollorë nuk janë transparente. Në të

7. A Key to Unlock the Past.

shumtën e rasteve historianët akademikë i krijojnë temat, ndërsa praktikuesit (kuadri arsimor) dhe kompetencat e tyre për mësim dhe ligjërime të historisë janë lënë pas dore. Autorët shqiptarë kanë një ndikim të kufizuar mbi konceptin e tërësishëm të librave shkollorë.

- Ngjarjet historike të vendit dhe rajonit janë me prapavijë konflikti dhe shpeshherë paraqesin një fushë të studimit të ekspertëve nacional dhe rajonal në njëzet vitet e fundit. Megjithatë, refleksionet, çështjet dhe debatet e tyre lidhur me cilësinë e librave shkollorë të historisë në Maqedoni nuk kanë sjellë ndryshime të konsiderueshme në librat shkollorë.

Rekomandimet në vijim nga analiza "A key to Unlock the Past" e vitit 2012, do të japin kontribut në realizimin e fushës së katërt dhe të gjashtë të konceptit:

- Kurikula momentale për historinë në Republikën e Maqedonisë duhet të ristudiohet dhe të rishqyrtohet, bazuar në zhvillimin e fundit të hulumtimeve historike si dhe në bazë të teorisë për edukim për historinë. Grupe të edukatorëve inovativë dhe të trajnuar të historisë si dhe historianë, por, gjithashtu edhe publiku më i gjerë, do të duhej të jenë të përfshirë në këtë proces. Qasja me "zgjidhje të shpejta" nuk është opsion. Për t'u lejuar krijimi i reformës

fundamentale, nevojitet një periudhë racionale prej dy deri në tre vjet.

- Arsimi sa i përket historisë duhet ta studiojë historinë e njerëzve të cilët jetojnë në Maqedoni, duke respektuar diversitetin, por, edhe ta kultivojë përkatësinë nëpërmjet tejkalimit të ndarjeve aktuale të narrativave maqedonase dhe shqiptare. Narrativat nga e kaluara duhet të jenë më mirë të balancuara ndërmjet aspekteve të cilat bashkojnë dhe aspekteve që shkaktojnë ndarje. Nevojiten shkathtësi dhe trajnime për studimin e diversitetit.

- Ekziston nevoja për krijimin e materialeve inovative digjitale edukative, me qëllim që ta bëjmë historinë një lëndë relevante dhe inkluzive për nxënësit. Kuadri arsimor i historisë dhe shkollat e tyre duhet të kenë resurse, dokumentacion, materiale vizuale dhe të tjera të spektrit të gjerë, të cilat e inkurajojnë interpretimin e historisë dhe interaksionin, që janë të nevojshme për mësimin dhe ligjërimit inovativ. Duhet të stimulohet përdorimi i mjeteve alternative edukative, të cilat do ta kompensojnë mungesën momentale të zgjedhjes në tregun komercial për libra shkollorë.

Librat shkollorë të historisë, analizë e vitit 2017 – ndërlidhje

Në vitin 2017, AMHM, përsëri në bashkëpunim me EUROCLIO dhe CDRSEE - Qendrën për Demokraci dhe Pajtim të Evropës Juglindore, e përgatiti publikimin E-Pakt⁸, që paraqet një raport hulumtues, me titullin “Mësimdhënësit për arsimin”. Ai jep një pasqyrë të qartë për atë se si mësimdhënësit e shikojnë gjendjen e atëhershme dhe zhvillimin e mëtejshëm të mësimdhënies së historisë në Ballkanin Perëndimor.

Ky raport hulumtues është detajor dhe i krijuar me fokus-grupe nga mësimdhënës dhe mësimdhënëse të rajonit të ish-Jugosllavisë. Përpunon tema të cilat janë kyçe për reformat e lëndës së historisë, siç janë: Trajnimi fillestar i mësimdhënësve; Punësimi dhe zhvillimi profesional; Mësimdhënësit në shkollat dhe sistemet arsimore; A ka ndryshuar paradigma arsimore; Temat kontroverse dhe temat e ndjeshme, si dhe diskutime dhe konkluzione.

Nga kjo analizë do të ndajmë vetëm një pjesë të rezultateve të cilat i konsiderojmë si të rëndësishme dhe relevante për këtë analizë të vitit 2021 dhe gjithsesi kanë të bëjnë edhe me kurikulën e historisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Ndërlidhjen me këtë raport hulumtues të vitit 2017 e bazojmë mbi faktin që momentalisht në të gjithë librat shkollorë të arsimit fillor dhe të mesëm, nuk studiohet

periudha nga pavarësimi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Historia e re nga fundi i shekullit të njëzetë deri më sot nuk përpunohet. Gjithsesi, kjo histori e vonë ka sfidat e veta, specifkën e vet, i mungon materiali i shkruar në bazë të të cilit do të krijohet programi i lëndës së historisë. Temat kontroverse dhe të ndjeshme, të cilat e trajtojnë historinë e vonë, fare nuk studiohen.

Një pjesë e rezultateve të raportit hulumtues është relevante edhe sot, në vitin 2021, ndërsa kanë të bëjnë me studimin e historisë së vonshme:

Në kapitullin 3.4.3. A ka kontribut më të madh arsimit në historinë, është theksuar siç vijon: Rezultatet tregojnë se disa mësimdhënës ndjehen shumë pakëndshëm duke ligjëruar tema kontroverse në shoqërinë e tyre. Disa prej tyre në tërësi e shmangin temën e luftërave të paradokohshme, ndërsa të tjerë ballafaqohen me të (faj individual në vend të fajit kolektiv, respekt ndaj diversiteteve) nëpërmjet temave të tjera (Holokausti, Lufta e Dytë Botërore).

Në pjesën 3.4.4. Temat e tjera dhe të vështira, për Republikën e Maqedonisë së Veriut është theksuar siç vijon: Rasti me Maqedoninë është pak më i ndërlikuar. Edhe pse ekzistojnë libra shkollorë të përbashkët të historisë (të përkthyer në të dy gjuhët), të cilët përmbajnë narrativa nga e kaluara, citat në vijim japin një pasqyrë interesante për atë se si ideja për një histori “të përbashkët” luan rol në praktikën arsimore.

Citat: Për të qenë e qartë, është një libër i njëjtë, i cili është edhe në gjuhën shqipe edhe në gjuhën maqedonase, por, se a do të sjell ndonjë material plotësues në orë të mësimi apo më shumë do t'i njoftoj nxënësit me tema të caktuara, kjo varet prej meje.

8. Autorë: Dea Mariq dhe Rodoljub Jovanović

Librat shkollorë të historisë, analiza e vitit 2021 – ndërlihdje

Më në fund, në këtë pjesë hyrëse të kësaj analize, do ta shpjegojmë procesin e përpunimit të përmbajtjeve dhe praktikave për mbajtjen e orëve të historisë të cilat trajtojnë tema etnike.

Është fakt se këtë analizë Aksioni Paqësor dhe AMHM e krijojnë në një distancë kohore prej gjithsej nëntë, respektivisht katër vjet, por, edhe në studimin e vitit 2012, edhe në raportin hulumtues të vitit 2017, sfidat janë të ngjashme, adresojnë probleme të cilat janë aktuale edhe sot, dhe mund të vërehet se nuk ka një kontinuitet institucional për tejkalimin e sfidave, të cilat janë përmendur në dy analizat.

Kjo gjendje, para së gjithash, është rezultat i faktit se librat shkollorë për lëndën e historisë nuk kanë përjetuar asnjë reformë. Kjo situatë vetëm i thëllon problemet, ndërsa kuadrit arsimor i mbetet të punojë me programe mësimore të vjetra dhe të tejkaluara.

Nga maji 2020, Aksioni Paqësor dhe AMHM inicojnë një proces për reforma në lëndën e historisë, më saktë për ndryshimin e librave, tani edhe në kushte të pandemisë me KOVID-19.

Ky proces përfshin një punë të thellësishme me një grup prej 18 mësimdhënësve dhe

mësimdhënësve të historisë në vend, të cilët ligjërojnë në shkolla fillore dhe të mesme të vendosura në mjedise urbane dhe rurale. Në këtë pjesë hyrëse do të theksojmë se përmes cilave tema i kemi përpunuar çështjet etnike për lëndën e historisë: Trajnim për ndërtimin e mirëbesimit dhe përpunim të temave të rëndësishme të së tashmes, të cilat ndikojnë mbi marrëdhëniet ndëretnike dhe dialogun ndëretnik, realizuar në periudhën 24-27 gusht 2020, në platformën Zum (Zoom). Realizimi ditor i programit ishte nga katër orë. Tema: **Përpunimi kontekstual dhe ndërtimi i grupit.**

- Realizimi i takimit të parë të dialogut në periudhën 24-25 shtator 2020 në platformën Zum. Realizimi ditor i programit ishte nga katër orë. Tema: Të kuptuarit e konflikteve dhe identiteteve etnike.
- Realizimi i takimit të dytë të dialogut në periudhën 13-14 nëntor 2020 në platformën Zum. Realizimi ditor i programit ishte nga katër orë. Tema: Multipartektiviteti, hyrje në ballafaqimin me të kaluarën dhe hyrje në drejtësinë tranzicionale.
- Realizimi i takimit të tretë të dialogut në periudhën 17, 18, 21 dhe 22 dhjetor 2020, në platformën Zum. Realizimi ditor i programit ishte dy ditë nga dy orë dhe dy ditë

nga tri orë. Tema: Përpunimi i rrëfimeve jetësore nga viti 2001, nëpërmjet një filmi dokumentar, dhe rrëfimet jetësore nga arkivi i Aksionit Paqësor, si dhe analiza e librave shkollorë të historisë nëpërmjet prizmit të paraqitjes së heronjve etnikë, rolit të gruas dhe narrativat të cilat përdoren në librat shkollorë të historisë.

- Krijimi i Praktikumit për realizim të orëve të historisë – mjet për realizimin e mësimit në distancë për shkollat fillore dhe të mesme, i krijuar nga kuadri arsimor i cili merr pjesë në këtë projekt, me qëllim të krijimit të aktiviteteve ndërshkollore në partneritet, të cilat përpunojnë tema të përbashkëta të historisë bashkëkohore. Gjithsesi, qëllimi i këtij praktikumi është që të jetë një burim i hapur për të gjithë mësime të historisë dhe t'i promovojë unitetin, vlerat demokratike dhe ndërtimin e paqes.

Ky proces është gjithsesi edhe ndërtim i kapaciteteve për kuadrin arsimor, por, gjithashtu, është komplementar me standardet nacionale dhe fushat katër (IV) dhe gjashtë (VI), të përshkruara në Konceptin për Arsim Fillor të MASH-it.

Angazhimi ynë e sinqertë është që këto përvija dhe rezultate të pasqyrohen në

arsimin e përgjithshëm fillor dhe të mesëm për lëndën e historisë. Kjo periudhë, kur duhet të pilotohen dhe të krijohen modulet për histori dhe shoqëri në arsimin fillor, mendojmë se është me rëndësi kyçe për të nisur një proces gjithpërfshirës të reformës së librave shkollorë të lëndës së historisë, ndërsa ky proces t'i përfshijë dhe t'i inkuadrojë mësime të historisë dhe mësime të historisë që e ligjërojnë këtë lëndë.

AMHM dhe Aksioni Paqësor i kanë ekspertizat, burimet dhe rezultatet dhe konsiderojmë se mund të jemi një përkrahje serioze, kur është fjala për ndërtimin e kapaciteteve, pilotimin e qasjeve inovative për lëndën e historisë dhe, gjithsesi, edukimin për temat të cilat e përpunojnë ndërtimin e paqes përmes ballafaqimit me të kaluarën, drejtësisë tranzicionale, interkulturalizmit, gjithsesi nëpërmjet prizmit edhe të çështjeve gjinore.

Metodologjia

Në këtë publikim japim udhëzime me rekomandime të përgjithshme për ndryshime në librat shkollorë të historisë dhe në perceptimet që i kanë kuadri arsimor për këtë nevojë, i inkuadruar në realizimin e këtij projekti. Gjithashtu, pikëpamje të vetat, të shprehura nëpërmjet analizës së librave shkollorë, kanë edhe dy ekspertët, rekomandimet dhe konkluzionet e të cilëve janë pjesë e këtij publikimi.

Për të arritur deri te krijimi i rekomandimeve, përdorëm disa metoda. Kishim një proces të ndërtimit të kapaciteteve për kuadrin arsimor, nëpërmjet procesit inkluziv dhe dialogut, ku krahas përpunimit të temave lidhur me ballafaqimin me të kaluarën, kulturën e kujtesës dhe ndërtimin e paqes, biseduam edhe për vetë librat shkollorë. Qasjen e dialogut për përpunimin e temave në librat shkollorë e bëmë nëpërmjet ndërtimit të besimit, si në mënyrë adekuate ta paraqesim historinë, çfarë janë pasqyrimet për ne dhe për të tjerët në librat shkollorë, analizuam se cilët persona janë përkrahur si heronj në librat shkollorë dhe, gjithsesi, biseduam se sa dhe si është përfaqësuar perspektiva gjinore. Ekipi i trajnerëve, gjithashtu, përdorte burime nga Aksioni Paqësor, lidhur me luftën dhe/ose përballjen luftarake të vitit 2001, si dhe rrëfimet jetësore dhe filmin dokumentar. Dokumentacioni detajor nga takimet dialoguese është në díspozicion me kërkesë.

Gjithashtu, si pjesë e këtij projekti, i përkrahëm mësimdhënësit dhe mësimdhënëset që të krijojnë praktika për realizimin e aktiviteteve jashtëmësimore ndërshkollore lidhur me lëndën e historisë. Kjo iniciativë rezultoi me resurs, për të gjithë mësimdhënësit dhe mësimdhënëset e historisë, që përpunon orë të realizuara në distancë. Konsiderojmë se lidhja dhe bashkëpunimi digjital paraqet një modernizim të komunikimit mes shkollave dhe se gjithsesi e ndjek hapin e gjeneratave të shekullit XXI.

Gjithashtu me rëndësi është që edhe publiku akademik ekspert të inkuadrohet me pikëpamje të vetat për librat shkollorë të lëndës së historisë. Për këtë qëllim, i angazhuam prof. dr. Katerina Todoroskën, nga Instituti i Historisë Kombëtare, dhe doc. dr. Zejni Mazllamin, nga Universiteti i Tetovës. Për koncipimin e pikëpamjeve të tyre, profesori dhe profesoresha i shqyrtuan dhe dhanë komentet e veta për librat shkollorë të arsimit fillor dhe të mesëm të lëndës së historisë⁹, kishin takim onlajn (on-line) me nxënësit dhe nxënëset, me kuadrin arsimor dhe u realizua një pyetësor për kuadrin arsimor, i cili nuk ishte pjesë e këtij projekti. Dy profesorët dhanë edhe pikëpamjet e tyre për realizimin e mësimin në distancë.

Një pjesë e punës së tyre është pjesë e këtij publikimi.

9. <https://www.e-ucebnici.mon.gov.mk/>

Pikëpamje të përgjithshme për nevojat për ndryshimin e librave shkollorë të historisë – takime dialoguese me kuadrin arsimor të historisë

Rekomandime të projektit

Grupi përbëhej nga 18 mësime dhe mësime, të cilët vinin nga mjedise urbane dhe rurale, nga vende të ndryshme të vendit: Shkup, Veles, Prilep, Kukureçan, Dobrushevë, Kavadar, Gostivar, Tetovë, Kumanovë, Koçan dhe Strumicë, si dhe një kustos nga “Muzeu Maqedonia”. Përfshirja e këtyre gjeografike na mundësoi që të ndajmë përvoja të cilat në mënyrë reale e pasqyrojnë gjendjen në shkollat fillore dhe të mesme, kur bëhet fjalë për analizën e lëndës së historisë. Kishim përfaqësues dhe përfaqësuese të 11 shkollave fillore komunale dhe shtatë shkollave të mesme komunale, nga të cilat tri gjimnaze dhe katër shkolla të orientuara/profesionale. Grupi prej 18 mësimeve dhe mësimeve përfaqësohej nga 11 gra dhe shtatë burra, nga të cilët 12 janë maqedonas etnikë, katër shqiptarë dhe dy serbe.

Që të mund të bisedohet për një analizë dhe identifikim të nevojave për ndryshime që duhet të bëhen në librat shkollorë të

historisë, punuam nëpërmjet takimeve për dialog. Këto takime për dialog kishin për qëllim që të sigurojnë një hapësirë të sigurt dhe të besueshme për diskutim në vetë grupin, për tema lidhur me ndërtimin e kulturës së kujtesës dhe ndërtimit të paqes.

Duke u nisur nga perceptimi se librat shkollorë të historisë nuk kanë ndryshuar që nga viti 2005 dhe janë krijuar me një program të vjetëruar, Aksioni Paqësor dhe AMHM krijuan një program për dialog dhe ndërtim të kapaciteteve të kuadrin arsimor. Programi i përmbante temat në vijim:

- Identiteti etnik
- Transformimi i konfliktiteve
- Multiperspektiva
- Hyrje në ballafaqimin me të kaluarën
- Hyrje në drejtësinë tranzicionale
- Hapja e dialogut dhe përpunimi i luftës së vitit 2001
- Çështjet gjinore

Për qëllimin e kësaj analize, do të theksojmë disa nga pikëpamjet e takimit të tretë për dialog¹⁰, ku biseduam për disa aspekte, të rëndësishme për procesin e ndryshimit të librave shkollorë të historisë:

Si do të duhet të duket një paraqitje adekuatë (gjithëpërfshirëse, reale, njerëzore dhe e ndershme) e historisë?

Librat shkollorë paraqesin një mjet themelor mësimor dhe një mjet për realizimin e mësimit dhe, me vetë këtë, cilësia e tyre është me një rol kyç. Në rast se për mësime ndërshtetërisht paraqesin një mjet arsimor ndihmës për realizimin e mësimit, ata për nxënësit janë një mjet arsimor themelor për marrjen e informatave për të kaluarën dhe mësimin e historisë. Përshtatshmëria ndaj shkathtësive dhe mundësive psikologjike-motorike dhe moshës së nxënësve ka një rol vendimtar. Duhet të jenë të shkruar me një stil gjuhësor lehtë të kuptueshëm për moshën e nxënësve, ndërsa narrativi të mos jetë nxitës, por të hapë një hapësirë për mendim kritik dhe sjellje të përfundimeve vetjake. Kjo gjë mund të arrihet me ndihmën e përdorimit të shpeshtuar të

burimeve parësore, të cilat do të përdoren në librat shkollorë ose do të rekomandoheshin si një material plotësues mësimor. Gjithsesi, e njëjta e stimuluar me ndihmën e pyetjeve, detyrave dhe aktiviteteve konkrete dhe të qarta, të cilat do ta stimulojnë procesin e mendimit kritik dhe zgjidhjes së problemeve. Kjo mund të arrihet para së gjithash me përdorimin e pyetjeve të llojit të hapur: Pse? Si? Me çfarë qëllimi?... , të cilat, fatkeqësisht, shumë rrallë përdoren për zhvillimin e shkathtësive të nxënësve. Diçka që është konstatuar si një nevojë esenciale në shekullin XXI në hulumtime të shumta ndërkombëtare relevante, konkluzione dhe rekomandime nga organizata të rëndësishme ndërkombëtare, nënshkruese e të cilave, mes tjerash, është edhe Republika e Maqedonisë së Veriut.

Hapja e temave kontroverze dhe të ndjeshme e meriton vendin e vet në një libër shkollor bashkëkohor dhe në programin mësimor në përgjithësi. Këto tema gjithsesi janë të pranishme në jetën e përditshme të nxënësve dhe, herët a vonë, çdonjëri prej tyre do të ballafaqohet me to. Në rast se këto tema nuk do të trajtohen në kuadër të lëndës së historisë dhe nuk do të jenë pjesë e kurikulës, dhe me këtë edhe në librat shkollor,

10. Dokumentacioni nga takimi i tretë dialogues është me pikëpamje detajore për analizën e librave shkollorë, i bërë nga kuadri arsimor i inkuadruar në këtë projekt.

atëherë lihet një hapësirë e madhe e lirë për trajtimin e tyre jashtë kontrollit dhe mjedisit të sigurt, siç është klasa. Kjo, në anën tjetër, mund të sjellë deri te thellimi i hendekut dhe ndarjes mes “nesh” dhe “atyre”, forcimi i paragjyqimeve, përhapja e urrejtjes, me të cilën gjë në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikohet ndaj stabilitetit dhe paqes në vend, por, edhe më gjerë në rajon.

Duke pasur parasysh tërë këtë, lehtë vërehet rëndësia e lëndës së historisë në ndërtimin e paqes, bashkëpunimit dhe përforcimit të stabilitetit të shtetit.

Në anën tjetër, librat shkollorë tejet të ngarkuar me fakte dhe të dhëna, moslidhja e tyre në një koncept të qartë dhe me një mesazh të qartë për promovimin e paqes dhe tolerancës, të hedhura me një interpretim të paqartë të së kaluarës, të bazuar në një stil të lartë të të shprehurit në librat shkollorë dhe moslidhja e përmbajtjeve mësimore, nuk mundësojnë që nxënësit ta shohin “pasqyrën e madhe” të ndërlidhjes së proceseve historike në botë, në rajon

dhe në Maqedoni. Me këtë, librat shkollorë nuk i shërbejnë qëllimit të tyre themelor. Njëkohësisht, shkaktojnë mosinteresim ndaj mësimit të së kaluarës dhe me këtë edhe ndaj kuptimit të së tashmes dhe rrethit të tyre.

Vendosja didaktike e librave shkollorë të cilët janë tani për tani në përdorim, nuk arrin t'i përmbushë nevojat për një zhvillim aktiv të mësimdhënies, në të cilin nxënësi është në qendër të mësimdhënies dhe vazhdojnë të shkruhen në mënyrën dhe në stilin e njohur “lexo dhe mbaj mend”, një gjë që ka rrënjët e thella në një sistem të cilin moti e kemi lënë pas si shoqëri, por, megjithatë, duket sikur ende kemi ngecur në të. Modernizimi i pjesës didaktike të librave shkollorë është hapi i parë drejt tejkalimit të këtij problemi retrograd.

Në pjesën e mëtejme të tekstit ju paraqesim pikëpamje të caktuara të arsimtarëve, të cilët ishin pjesë e këtij projekti, sa u përket çështjeve çka duhet një libër shkollor / çka nuk duhet një libër shkollor të përmbajë dhe në cilat parime duhet të bazohet:

Çka të përmbajë?

- Fakte / dokumente origjinale / fotografi
- Një pjesë të vogël të burimeve historike, të ndara, kur shpjegohet një ngjarje / pasuri me burime historike për të parë më mirë ngjarjen nga më shumë anë
- Rrëfime nga jeta e përditshme e njerëzve për një ngjarje, proces, periudhë të caktuar
- Rrëfime personale të njerëzve të zakonshëm, histori gojore
- Shpjegim të arsyeve për një ngjarje të caktuar
- Atje ku është relevante: pamje nga “pala tjetër”
- Çështje të ndjeshme (të cilat ruhen nën qilim)
- Realiteti (ajo që është, të jetë)
- Të përmbajë histori, jo fakte të cilat i imponon garnitura politike në një periudhë të caktuar
- Shikimi i një ngjarjeje/dukurie si pjesë e tërë pasqyrës, jo sikur është e pavarur nga gjithçka tjetër
- Pasqyra shoqërore-politike dhe kulturore në çastin kur hulumtohet ajo ngjarje
- Nxjerrja e mësimi nga pasojat
- T’i humanizojë aktorët
- Hulumtim të ndershëm të asaj që ka ndodhur
- Multiperspektiva
- Të mos përmbajë opinionie të njëanshme, të mos ketë “një të vërtetë”, të ketë një multiperspektivë
- Të mos ketë konkluzione të imponuara, të lëmë që nxënësit të mund të sjellin një vendim individual
- Të mos ketë tekst të tepruar
- Të paraqiten anët pozitive dhe negative

Çka të mos përmbajë?

- Të mos ketë përçmim të njërit ndaj tjetrit. Të ketë respekt.
- Të mos ketë interpretim, por t' u lihet fëmijëve që të nxjerrin përfundime në bazë të fakteve, dëshmive etj.
- Të mos ketë qëndrim të njëanshëm të përmbajtjeve
- Të mos përmbajë fyerje, më saktë fjalë fyese. Të mos ketë gjuhë urrejtjeje
- Të mos ketë përmbajtje me gabime faktografike
- E vërteta të interpretohet në mënyrë objektive, që të mund të merremi vesh
- Të mos ketë gabime në përkthim. Përkthimet të jenë profesionale dhe të lekturohen
- Të mos ketë mesim vetëm në klasë
- Të mos ngarkohet materiali me fakte të panevojshme (data, persona)
- Recensionet e përkthimeve të librave shkollorë të historisë të bëhen nga historianë
- Të mos ketë mendime sugjestive. Të mos ketë një narrativ nxitës
- Të mos ketë fjali me kahe stereotipe dhe diskriminuese
- Të mos ketë shprehje të nacionalizmit, racizmit e të ngjashme
- Të mos ketë propagandë.

Në cilat parime të bazohet?

- Bashkimi i diversiteteve
- Metoda bashkëkohore (multiperspektivë)
- Realitet i bazuar në parime shkencore
- Parime të objektivitetit dhe të kredibilitetit
- Krahasim
- Hulumtim
- Shkencë

Cilat janë mesazhet të cilat dëshirojmë t'i dërgojmë si historianë?

Sikur të ishe personalisht i/e inkuadruar në reformat, çka do të kishe reformuar? - Deklarata

- Mesazhi im është që të mos shpejtohet. Të inkuadrohen njerëz të praktikës. Nuk mund dikush i cili nuk ka qenë në arsim të marrë vendime.
- Unë do ta kisha reformuar programin dhe mënyrën e punës. Vlerësojmë shkathtësi për të memorizuar. Të ndryshojë mënyra e vlerësimit të nxënësve. Të mos vlerësohet faktografia, memorizimi.
- Gjithçka do të kisha ndryshuar në programin mësimor, si dhe mënyrën e ligjërimit dhe vlerësimit.
- Si përvojë, mund të ndaj se në një periudhë isha i angazhuar si profesor i historisë në një shkollë private në Shkup. Kisha një liri më të madhe në përgatitjen e materialit mësimor, zgjedhjen e librave shkollorë dhe planifikimin e orëve, që ishte një sfidë dhe ishte më mirë e vendosur mënyra e punës, krahasuar me shkollën shtetërore. Pastaj u informova se për shkak të nevojës së akreditimit ndërkombëtar, shkolla është duke përgatitur një program të ri mësimor, i cili e përfshin integrimin e më shumë lëndëve në një, ndër të cilat edhe historinë. Më thanë se për shkak të kësaj, shkolla ka nevojë për një kuadër më adekuat, me arsimim jashtë Maqedonisë dhe i cili jo domosdoshmërisht duhet të jetë historian. Ndoshta duhet të mendojmë për zgjerimin e botëkuptimeve dhe diapazonin e mësimit të historisë. E vendosur kështu, atë sikur e shkel koha. Duhet të jemi më të hapur për ide të reja.
- Do ta kisha ndryshuar historinë sipas përvojës së seminarëve të këtyllë. Të mësohet për të kaluarën, por jo nga perspektiva e sotme.
- Reforma, PO! Ka nevojë për ndryshim të programit, por, largimi i tërësishëm i historisë, jo. Historia duhet të mbetet.
- Nevojitet një konsensus i gjerë. Duhet të jepet kohë për reforma. Të gjenden mangësitë dhe të punohet mbi to. Historia e jep mundësinë për zhvillimin e mendimit kritik. Ajo duhet t'i centrifugojë shkencat e tjera shoqërore. Të jetë një mësuese e vërtetë e jetës. AMHM ka bërë programe alternative mësimore në të kaluarën. Jemi vetëzhvilluar. Jemi relevantë dhe ka nevojë për një koncept, por të zhvillohet në një drejtim të kundërt.
- Nevojitet një trajnim për mësimdhënësit për metodat e reja të punës. Ne kemi zero trajnime nga ana e sistemit si historianë. Mësimi gjatë tërë jetës, për shembull. Pse nuk promovohet te kuadri arsimor? Kjo duhet të jetë sistematike, e jo vullnetare.

Puna me fokus-grupe për nevojat e analizës me prof. dr. Katerina Todoroska dhe doc. dr. Zejni Mazllami

Puna e pjesëmarrësve dhe punëtorëve shkencorë - analiza e librave shkollorë

Me qëllim që të njihemi me punën dhe qëllimin e këtij projekti, mbajtëm dy mbledhje, më 14 janar 2021 dhe më 11 shkurt 2021, nëpërmjet platformës Zum. Në këto mbledhje, nga ana jonë u kërkua një takim me nxënësit dhe mësime të cilët kanë marrë pjesë në këtë projekt.

Takime me nxënësit dhe nxënëset e arsimit fillor

Më 12.02.2021 u realizua takimi i parë në Zum, në prani të arsimtarëve, me nxënësit e shkollave fillore.

Në këtë takim, me nxënësit biseduam për disa tema, me interes për projektin. Njëra nga temat ishin librat e historisë. Vërejtja dhe komentet për tekstet në to dhe kuptueshmëria e tyre për nxënësit. Çdo nxënës e dha pikëpamjen e vet për mënyrën dhe stilin në të cilin janë shkruar temat e përpunuara në librat shkollorë. Pasqyra e përgjithshme të cilën e fituam dhe e transmetuam, në bazë të qëndrimeve të nxënësve, është si vijon:

- Nxënësit nuk mësojnë nga librat shkollorë, por nga ajo që mësime të cilët ua transmetojnë për një mësim

të caktuar. Arsyeja është stili i lartë i shprehjes në to, tekstet e stërbushura me emra dhe vite. Kështu që, nxënësit nuk janë në gjendje t'i memorizojnë të gjitha të dhënat faktografike.

- Në nxënien e materialit të dhënë shumë u ndihmojnë prezantimet e mësimeve, të cilat janë përgatitur në mënyrë të qartë dhe të lehtë për ta kuptuar.

- Nxënësit kanë vërejtje që në librat shkollorë mësohet shumë më tepër për historinë politike, ndërsa mungon historia e jetës së përditshme dhe ngjarjet e përgjithshme në një periudhë, si për shembull historia e sportit.

- Nxënësit të cilët mësojnë në gjuhën shqipe shprehën vërejtje për përkthimet e librave shkollorë. Kështu, disa mësime i kanë të pakuptueshme dhe këtë e korrigjojnë mësimeve, të cilët gjithmonë e shpjegojnë atë që është e palogjikshme në tekstin e ndonjë mësimi.

Gjatë takimit me nxënësit e shkollave fillore u shpreh dëshira nga disa prej tyre që t'i japin propozimet e veta në lidhje me librat shkollorë të historisë. Propozimet të cilat i morëm, deri në përmblyllje të analizës, i japim në një formë në të cilën nxënësit na i dorëzuan.

Në pyetjen: “Çka do të ndryshoja unë në librat shkollorë të historisë”, disa nxënës u përgjigjën:

- Të ketë tekst më të kuptueshëm;
- Më shumë të shkruhet për jetën e përditshme dhe kulturën e popujve;
- Të ketë më shumë harta në të cilat më mirë do të paraqiten territoret e shteteve;
- Të ketë fjalë më të qarta apo fjalor me shpjegim të disa termeve;
- Mësimet të jenë më të shkurtra dhe në to të paraqiten vetëm gjërat themelore dhe thelbësore;
- Në fund të çdo mësimi të ketë një konkluzion me gjërat më të rëndësishme.

Takim me nxënës dhe nxënëse të shkollave të mesme

Takimi i dytë në internet me profesorë dhe nxënës të shkollave të mesme u mbajt më 18.02.2021.

Duke pasur parasysh faktin se këta nxënës janë më të moshuar dhe e kanë kryer arsimin fillor, tek ata u vërejt një elokuencë më e madhe dhe një nevojë më e theksuar për ta shprehur mendimin personal për një spektër më të gjerë të temave.

Duke u nisur nga përgjigjet e tyre, i nxorëm konkluzionet në vijim:

- Njëzëri thanë se materiali të cilin e mësojnë në shkollë të mesme po përsëritet nga shkolla fillore, në mënyrë vetëm pak më të zgjeruar. Për shkak të kësaj, një pjesë e tyre kërkojnë që të ketë një qasje më të ndryshme dhe më interesante ndaj temave, ndërsa për

këtë qëllim propozojnë të pakësohet historia politike. Pasurimi do të bëhej me histori të sportit, histori të kulturës, histori të informatikës dhe histori të jetës së përditshme.

- Në mësimet ka tepër shumë faktografi e cila duhet memorizuar, që për nxënësit është e pamundur, sepse kanë edhe lëndë të tjera për të mësuar. Kështu që, vërejtja është që të bëhet një racionalizim i datave dhe emrave të pjesëmarrësve të ngjarjeve.

- Monotonia e cila është e pranishme në mësimet të caktuara do të largohet me më shumë elemente plotësuese. Prandaj, propozimi i nxënësve është që të përfshihen më shumë harta, fotografi dhe faksimile të dokumenteve, të cilat pastaj do të analizohen në orë të mësimet.

Realizimi i pyetësorit për kuadrin arsimor të përfshirë në realizimin e projektit dhe kuadrin arsimor i cili nuk ka qenë i përfshirë në projekt

Për nevojat e analizës sonë, u hartua edhe një pyetësor me 10 pyetje. Gjatë kësaj, u anketuan 25 mësimdhënës të punësuar në arsimin fillor dhe të mesëm, 15 prej tyre u përfshinë në projekt dhe 10 ishin jashtë projektit.

- Shumica e mësimdhënësve mendojnë se librat shkollorë të lëndës së historisë janë me një koncept dhe përmbajtje të vjetëruar, kanë nevojë për ndryshime të dukshme.
- Të gjithë mësimdhënësit, pa përjashtim, kanë vërejtje për lëshimet në librat shkollor, ndërsa vetëm një pjesë e tyre ka reaguuar në takimet e ndërsjella në shkollat e tyre, por pa ndonjë rezultat. Nuk ka pasur reagime nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, me arsyetimin se vërejtjet e tyre nuk do të shqyrtohen dhe nuk do të pranohen.
- Të gjithë mësimdhënësit e anketuar janë përgjigjur se në tërësi i kanë respektuar planet dhe programet mësimore. Ka edhe të tillë të cilët kanë bërë modifikime dhe plotësime të caktuara, të cilat i kanë konsideruar si të domosdoshme.
- Mësimdhënësit e anketuar konsiderojnë se temat e ndjeshme duhet të ligjërohen

me më pak pasion, me më shumë vëmendje dhe shpjegime plotësuese.

- Të gjithë mësimdhënësit, pa përjashtim, janë të mendimit se në librat shkollorë ka më shumë sesa duhet histori politike dhe luftarake, ndërsa më pak nga historia shoqërore dhe kulturore.
- Pjesa më e madhe e librave shkollorë është me një histori të përbashkët të Republikës së Maqedonisë, me një narrativë më pak kombëtar, që të mësohet historia e shqiptarëve në Maqedoni, ndërsa historia e popullit shqiptar të jetë e trajtuar si historia e fqinjëve të tjerë. Një pjesë më të vogël të mësimdhënësve të anketuar nuk u pengon që edhe në të ardhmen të ndahen në mënyrë tematike.
- Pjesa më e madhe e mësimdhënësve është për ruajtjen e temave problematike, por vetëm nëse kjo është në funksion dhe me qëllim final për një ballafaqim të drejtë me të kaluarën, për shkak të mirëkuptimit të ndërsjellë, tolerancës, bashkëjetesës etj. Një pjesë më e vogël është përgjigjur se këto tema duhet të mënjanohen, për shkak të moshës së nëxësve.
- Pothuajse të gjithë mësimdhënësit e anketuar vlerësojnë se ngjarjet e vitit 2001 duhet të jenë pjesë e planeve dhe programeve

mësimoe. Duhet të përpunohen në mënyrë faktografike, pa emocione dhe anime. Konsiderojnë se ngjarjeve duhet t'u qaset nga më shumë aspekte. Një pjesë e mësimdhënësve është kundër, me arsyetimin se nuk ka një distancë të mjaftueshme kohore.

- Të gjithë mësimdhënësve të anketuar u pengon, ndërsa një pjesë e tyre janë të shqetësuar për keqpërdorimin e ngjarjeve dhe personave historikë për qëllime politike, sidomos kur ka një interpretim të gabueshëm të fakteve historike, por nuk e vënë theksin mbi atë gjatë ligjërimit.

- Të gjithë mësimdhënësit e anketuar të cilët janë përfshirë në këtë projekt dhe ata jashtë projektit mendojnë se projektet dhe punëtoritë janë me interes të posaçëm dhe janë një ndihmë e madhe, sepse kontribuojnë për sendërtimin profesional dhe u ndihmojnë për kuptimin më të mirë dhe interpretimin më të ndryshëm të temave historike.

Takim me kuadrin mësimdhënës

Krahas kësaj, më 15.04.2021, u mbajt takimi i mësimdhënësve, në Zum, në të cilin morën pjesë të gjithë 18 mësimdhënës, të cilët ishin pjesë e projektit:

Kuadri arsimor, gjatë këtij takimi, i konfirmoi disa nga qëndrimet tona nga analiza e librave shkollorë të historisë, por dhanë edhe sugjerime shumë të dobishme. Pikëpamjet e tyre janë pjesë e konkluzionit dhe rekomandimeve.

Rekomandime nga prof. dr. Katerina Todoroska dhe doc. dr. Zejni Mazllami

Duke pasur parasysh përbërjen multietnike të popullatës në Maqedoni, vlerësojmë se mësimet në librat shkollorë të historisë duhet t'i referohen historisë shtetërore.

Librat shkollorë të historisë, të cilët janë aktualisht në përdorim, janë punuar në bazë të programit të vjetëruar mësimor, sepse që nga viti 2005 nuk ka ndryshime të planeve dhe programeve mësimore për arsimin fillor dhe të mesëm. Kjo kërkon ndryshimin e tyre urgjent dhe qasje ndaj modernizimit të mësimet të historisë dhe librave mësimorë për realizimin e tij.

Në 30 vitet e kaluara në nivel global dhe shtetëror janë bërë ndryshime të rëndësishme, studimi i të cilave është i domosdoshëm në kuptimin e historisë. Kjo do të thotë vënie të theksit në aktivitetet e përbashkëta të të gjithë pjesëmarrësve në jetën e përditshme të shtetit maqedonas. Në këtë kuptim, në librat e historisë duhet të mësohet periudha e shpërbërjes së federatës jugosllave dhe arsytet për pavarësimin e Republikës së Maqedonisë si një shtet sovran.

Historia bashkëkohore e Republikës së Maqedonisë është e pasur edhe me data dhe ngjarje

me karakter ndërkombëtar, nga të cilat do ta përmendim vetëm 8 prillin 1993, kur Republika e Maqedonisë u pranua në OKB. Kjo nuk do të thotë se datat e tjera janë më pak të rëndësishme, por, mësimi i tyre kërkon një eksplikacion të gjerë, e cila vlerësojmë se për nxënësit e arsimit fillor nuk është e rekomandueshme.

Për shkak të perceptimit për modernizim të librave shkollorë maqedonas të historisë, konsiderojmë se ata duhet të përmbajnë tema të cilat te nxënësit do të nxisin përbashkësi dhe përkatësi në një shtet multietnik. Në këtë mënyrë, në bazë të njohurive për një bashkëpunim të përbashkët të mëparshëm të veprimtarëve të etnive të ndryshme në territorin e Maqedonisë, duhet të sendërtohen ndjenjat për përkatësi ndaj shtetit dhe nevoja për një prosperitet të tij të ardhshëm.

Për arritjen e këtij qëllimi, rekomandimi ynë është se në librat shkollorë të historisë duhet të mësohet historia e përgjithshme në klasën VI, VII dhe VIII, ndërsa në klasën IX të vihet theksi mbi historinë shtetërore. Kjo do të thotë se do të ketë të bëjë, në një masë më të madhe dhe më të ndërlkuar, edhe me

nxënësit e vitit të katërt të arsimit të mesëm edhe për nxënësit e viteve përfundimtare të arsimit të orientuar. Në këtë mënyrë, nxënësit do të njoftoheshin edhe me ngjarje dhe personalitete që kanë marrë pjesë në krijimin dhe zhvillimin e shtetit të tyre. Me këtë do të ulej tensionin mes mësimdhënësve dhe nxënësve të etnive të ndryshme të cilët e bëjnë shtetin maqedonas të pasur dhe unik, që do të arrihej me uljen e njësive mësimore në të cilat flitet për një histori politike dhe luftarake, dhe shtimin e temave të jetës së përditshme, historisë së kulturës, historisë së sportit, historisë së teknikës etj.

Rekomandimi ynë në vijim ka të bëjë me mënyrën e përgatitjes së librave shkollorë. Sipas mendimit tonë, në të gjitha nivelet e përgatitjes, përfshirë edhe në shkrimin e librave shkollorë, domosdo duhet të jenë të pranishëm edhe mësimdhënësit nga procesi mësimor. Këtë qëndrim tonin e mbështesim në përvojën e deritanishme me moskuptueshmërinë dhe dendësinë faktografike të teksteve në librat shkollorë, të cilat në librat aktualë shkollorë të historisë janë shkruar me një stil të lartë, i cili nuk korrespondon as me moshën e nxënësve, e as me përgatitjen e tyre që ta kupojnë një tekst i cili është voluminoz dhe njëkohësisht i pashpjeguar në një mënyrë të kuptueshme.

Në librat shkollorë të ketë më shumë harta, faktografi, faksimile

dhe elemente të tjera vizuale, të cilat do të korrespondojnë me njësitet mësimore dhe do të ndihmojnë në kuptimin e tyre.

Njëkohësisht, për të mësuarit më të lehtë të njësive mësimore, rekomandojmë përgatitjen e doracakëve elektronikë dhe librave leximorë historikë.

Librat e përgatitur në këtë mënyrë do ta mënjanojnë mundësinë e përdorimit të retorikës nacionaliste në procesin arsimor, do të tejkalohet bietniciteti i deritanishëm i materialit në librat shkollorë, ndërsa nxënësve do t'u mundësohet të mësojnë edhe për rolin e, thënë kushtimisht, tjetrit në ndërtimin e shtetit multietnik maqedonas.

Libri bashkëkohor i historisë në bazë duhet të ofrojë një laramani mundësish, jo vetëm në fitimin e dijes, por edhe në nxitjen dhe zhvillimin e shkathtësive të cilat janë shumë të nevojshme në jetën bashkëkohore. Këtu sidomos e kemi parasysh shkathtësinë e të menduarit kritik dhe zgjidhjes së problemeve, për të cilën lënda e historisë ofron një hapësirë të gjerë. Për arritjen e këtij qëllimi librat shkollorë duhet të jenë të modernizuar nga aspekti didaktik dhe të të pasurohen me një material të ilustruar, i cili është në funksion të analizës dhe interpretimit (harta historike, prezente grafike,

tabela, burime parësore...), si dhe për ndërtimin e qëndrimit personale të nxënësit sa i përket një procesi të caktuar historik.

Njëkohësisht, ngrohtësisht rekomandojmë një prani të boshteve kohore dhe hartave në librat shkollorë, me të cilën gjë mundësohet një orientim më i lehtë i nxënësve në kohë dhe hapësirë, gjegjësisht njohja më e lehtë e proceseve dhe ngjarjeve historike. Gjatë kësaj, ato të korrespondojnë me narrativat e librave shkollorë, si dhe të ofrojnë informata përkatëse për ngjarjet të cilat mësohen, gjegjësisht të vihen në funksion të mësimdhënies aktive.

Shfrytëzimi i burimeve historike (dokumenteve) me karakter parësor është me rëndësi thelbësore dhe e meriton vendin e vet në librat shkollorë dhe, gjithsesi, në materialet plotësuese mësimore, të cilat, për fat të keq, nuk janë më të pranishme në procesin mësimor, si plotësim të librave shkollorë ekzistues. Diçka që në të kaluarën ishte një praktikë e zakonshme. Me shfrytëzimin e tyre, jo vetëm që u rrit interesi i nxënësve për hulumtimin e së kaluarës, por do të paraqesë edhe një vlerë plotësuese të narrativave nga librat shkollorë.

Jeta bashkëkohore dhe rrjedhat moderne kërkojnë përshtatje të vetë mësimdhënies ndaj shfrytëzimit të formave

elektronike të librave shkollorë, doracakëve dhe materialeve plotësuese mësimore. Përgjegjësia jonë është që atyre t'u gjejmë vend edhe në mësimdhënie. Kjo paraqet një sfidë së cilës duhet përgjigjur, sepse hap mundësi të shumta për rritjen e interesit për studimin e lëndës së historisë dhe prandaj meriton një kujdes të posaçëm që, fatkeqësisht, duhet ta konstatojmë se nuk është rasti tani.

Këto rekomandime do ta hapnin rrugën ndaj transformimit të librave shkollorë nga dija e sublimuar të cilën nxënësit e memorizojnë, ndaj librit si një mjet i kuptimit të së kaluarës dhe proceseve të cilat e formësojnë të tashmen. Në fakt, ky është edhe drejtimi i cili rekomandohet në dokumente të shumta ndërkombëtare, të cilat ne si shtet i kemi nënshkruar dhe i kemi pranuar në mënyrë deklarative. Ka ardhur koha për implementimin e tyre!

Konkluzione nga prof. dr. Katerina Todoroska dhe doc. dr. Zejni Mazllami

Duke i sublimuar rezultatet e aktiviteteve, lirisht mund të themi se librat shkollorë të lëndës së historisë janë me një koncept dhe përmbajtje të vjetëruar, kanë nevojë për ndryshime cilësore me modernizimin e tyre, sepse nuk përputhen me standardet bashkëkohore shkencore, metodologjike dhe didaktike, të cilat përdoren në Evropë dhe në botë.

Për këtë mangësi është reaguuar me vite në takimet e ndërsjella të historianëve, si nga kuadri shkencor, ashtu edhe nga ai arsimor, por, pa ndonjë rezultat sa i përket reaksionit nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Byrosë për Zhvillimin e Arsimit.

Në librat shkollorë ka një theksim të madh të historisë politike dhe luftarake, kështu që rreth 70-75 për qind të njësive mësimore në librat shkollorë kanë të bëjnë me historinë politike dhe luftarake, ndërsa temat lidhur me ekonominë, shoqërinë, religjionin, arsimin dhe kulturën në tërësi janë paraqitur me 25-30 për qind. Në këtë mënyrë, numri më i madh i mësimdhënësve janë ballafaquar me tema problematike, të cilave u janë shmangur gjatë mësimdhënies. Në fakt, në pajtim me planet mësimore të historisë,

në librat shkollorë janë përfshirë 48 njësi mësimore, ndërsa mësimdhënësi e ka lirinë që prej tyre të zgjedhë 36 njësi mësimore. Kjo krijon një hapësirë për një sjellje sipas vullnetit personal të mësimdhënësve, kështu që disa nga nxënësit, varësisht nga përkatësia kombëtare, nuk kanë mësuar njësi mësimore për grupet e tjera etnike, por vetëm për të vetin. Në këtë mënyrë krijohet një animozitet të fëmijët e bashkësive të tjera etnike në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në vend që njësitë mësimore të shërbejnë për njohjen e të tjerëve. Në këtë drejtim është edhe keqpërdorimi i ngjarjeve dhe personazheve historike për qëllime politike, sidomos kur ka një interpretim të gabuar të fakteve historike, pa u vënë theksi gjatë kësaj te koha për të cilën ka të bëjë.

Fakt i pamohueshëm është se në librat shkollorë të historisë më shumë shkruhet për historinë e përgjithshme të shqiptarëve, gjegjësisht për historinë e shqiptarëve të Shqipërisë, më pak për shqiptarët e Kosovës dhe pothuajse asgjë për historinë e shqiptarëve etnikë në Republikën e Maqedonisë. Në këtë mënyrë fitohet përshtypja se persona të kombit shqiptar në Maqedoni nuk kanë marrë pjesë në ngjarjet e përditshme në shtetin

maqedonas gjatë historisë, që është krejtësisht e kundërt me gjendjen reale.

Një problem i veçantë në librat shkollorë aktualë të historisë është përkthimi i librave shkollorë nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe, dhe anasjelltas. Në fakt, jo rrallë nga përkthyesit përdoren dialekte, gjë që sjellë huti te nxënësit sa i përket temës e cila përpunohet. Ka raste edhe kur në librat shkollorë në gjuhën shqipe, gjatë përkthimit, janë larguar kapituj të tërë nga versioni maqedonas i librit shkollor.

Është evidente se librat shkollor, pa përjashtim, kanë gabime të caktuara drejtshkrimore dhe teknike. Vërejtja e tillë, gjithashtu, reflektohet edhe mbi faktin se në librat shkollorë nuk është zbatuar një standard i vetëm për emrat gjeografikë dhe personalë. Një theks i veçantë në këtë raport mund të vihet në hartat apo fotografitë që janë të pranishme në librat shkollorë si një përkrahje vizuale e tekstit. Një problem jo më pak i rëndësishëm është mospërputhja e materialit vizual me atë tekstual, gjë që te nxënësit krijon një konfuzion, në vend të sqarimit të njësisë tematike.

Edhe krahas faktit që në përpilimin e programeve mësimore kanë marrë pjesë edhe mësimdhënës të arsimit fillor dhe të mesëm, si autorë të librave shkollorë hasen më së shumti profesorë të arsimit të lartë dhe të shkencës, kështu që tekstet kanë fituar një stil të lartë të shprehjes,

të pakuptueshëm për nxënësit. Një problem plotësues ndaj stilit të shkruarit paraqesin mësimet e ngarkuara me faktografi, që është e vështirë për ta memorizuar për nxënësit, ndërsa vende-vende është edhe e tepërt. Fitohet përshtypja se autorët e librave shkollorë vetëm kanë hedhur të dhëna, sa për të përmbushur ndonjë kriter për vëllimin e materialit, e jo për përdorimin e tij praktik në procesin mësimor. Për këtë arsye, mësimdhënësit janë detyruar ta thjeshtësojnë materialin dhe ta bëjnë të kuptueshëm dhe në dispozicion për fëmijët e moshave të ndryshme. Librat shkollorë të këtillë krijojnë aversion te nxënësit ndaj lëndës mësimore, në vend që t'ua ngjallin dëshirën për hulumtim të së kaluarës së familjeve të tyre dhe të kaluarës së përgjithshme. Baza e këtij problemi gjendet në faktin se gjatë përzgjedhjes së autorëve të librave shkollor, pa bazë favorizohen autorë të shkencës dhe arsimit të lartë, pa praninë e kuadrit arsimor në ekip, edhe pse mësimdhënësi e di mentalitetin dhe zhvillimin intelektual të nxënësve gjatë viteve.

Librat shkollorë të historisë të cilët janë në përdorim janë shfrytëzuar me vite, gjë që ka sjellë deri te amortizimi i tyre. Nxënësit mësojnë prej librave të dëmtuar, ndërsa për disa klasë fare nuk është hartuar një libër shkollor me vite. I këtillë është shembulli me librat shkollorë për nxënësit të cilët vizitojnë një

arsim dual, pastaj me nxënësit e shkollave të mesme, ku historia si lëndë mësohet dy-tre vjet. Prandaj, kuadri mësimor e realizon mësimdhënien në bazë të planeve arsimore, ndërsa nxënësit mësojnë nga shënimet në fletore.

Analiza jonë dhe rezultatet e fituara nga komunikimi me nxënësit dhe mësimdhënësit sa u përket librave shkollorë të historisë tregoi se librat shkollorë nuk përmbajnë tema të mjaftueshme për bashkësitë e tjera etnike në Maqedoni, përveçse për maqedonasit dhe shqiptarët, me të cilën gjë fitohet përshtypja për një shtet binacional. Në këtë mënyrë, në vend se të krijohet një ndjenjë për një bashkësi dhe bashkëjetesë në një shtet të përbashkët, te nxënësit zhvillohet ndjenja e dominimit dhe nënshtrimit të një etnie të caktuar. Librat shkollorë përmbajnë një material i cili ka të bëjë me historinë politike dhe atë të luftës gjatë historisë në territorin maqedonas, ndërsa nuk jepet një hapësirë e mjaftueshme për temat lidhur me bashkëjetesën, tolerancën, lëvizjet shoqërore, rolin e gruas etj.

Për organizatat

Мировна акција / Aksioni Paqësor

Aksioni Paqësor u formua në vitin 2001, me bashkimin e më shumë grupeve joformale të pacifistëve, antimilitaristëve dhe kundërsuesve të ndërgjegjes. Misioni ynë është promovimi i paqes dhe kulturës së mosdhunës. Në pesë vitet e para të ekzistimit tonë, theksi i punës sonë ishte vënë në njohjen e kundërshtimit të ndërgjegjes (Conscientious objector - KN), pastaj në zbatimin e tij dhe heqjen konsekuente të shërbimit të detyrueshëm ushtarak.

Nga viti 2006 filluam me punë edhe në programin e dytë të "Programit Rajonal për Antidiskriminim", i cili u fokusua në ndërtimin e të rinjve dhe njohjen dhe reagimin e dukurive të ndryshme të diskriminimit. Në këtë program, së bashku me aktivistët dhe aktivistet e Aksionit Paqësor u përfshinë të rinj të organizatave qytetare nga Serbia, BeH, Kosova, Kroacia dhe Maqedonia.

Në periudhën nga viti 2007 deri më sot, Aksioni Paqësor zhvillohet dhe përforcohet si në nivelin lokal/kombëtar, ashtu

edhe në atë rajonal, sa i përket aktivizmit për çështje paqësore, lëvizje dhe zhvillim të politikave. Në Maqedoni është pionier i zhvillimit të metodologjisë për mbledhjen e rrëfimeve jetësore, nëpërmjet historisë gojore dhe në këtë fushë u specializua me ekspertizën specifike. Këtë metodologji në mënyrë specifike e shfrytëzon për mbledhjen e rrëfimeve jetësore nga ngjarjet gjatë konfliktit të armatosur në vitin 2001.

Në këtë drejtim, Aksioni Paqësor edukon individë të cilët mbledhin rrëfime jetësore, nëpërmjet metodologjisë së zhvilluar të intervistimit dhe krijimit të shënimeve të përhershme historike. Puna e këtillë pastaj është në proces të digjitalizimit, së bashku me shkrimet gazetareske për ngjarjet e vitit 2001, duke krijuar bazë të të dhënave, e cila mundëson një dokumentim të përhershëm me një qasje publike për palë të ndryshme të interesuara.

Nga viti 2013 deri më sot, Aksioni Paqësor punon në

ndërtimin e paqes, nëpërmjet realizimit të trajnimeve me aktivistë/aktivistetë interesuar/a, puonjës/e paqësor/e, qytetarë dhe qytetare. Këto trajnime realizohen nga ekipi trajnues i organizatës dhe ato zbatohen në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe. Në këtë drejtim, Aksioni Paqësor u zhvillua në një organizatë me një ekip trajnuesish i cili punon në ballafaqimin me të kaluarën me grupe të ndryshme të interesit, nëpërmjet programit paqësor të dizajnuar specifikisht për çdo trajnim, bazik apo të përparuar.

Kur flasim për ballafaqimin me të kaluarën, e pashmangshme është puna me veteranët e luftës të të dyja palëve. Aksioni Paqësor i përfshin ata në aktivitetet e veta, nëpërmjet iniciativave rajonale, siç është Iniciativa Rekom, promovimet lokale të librave me rrëfime jetësore, ngjarje në organizim të Aksionit Paqësor, ekspozita dhe punë grupore nëpërmjet punëtorive.

Aksioni Paqësor, gjithashtu, punon me kuadrin arsimor

të shkollave fillore dhe të mesme në fushën e ndërtimit të paqes. Nëpërmjet ndërtimit të kapaciteteve për një arsim të integruar interetnik te kuadri arsimor dhe shërbimet profesionale, por edhe një përfshirje aktive të nxënësve. Arsimi është një hap përpara në kuptimin e specifikave të diversiteteve dhe interkulturalizmit. Në këtë proces, Aksioni Paqësor gjithashtu siguron një mentorim të grupeve të mësimdhënësve me të cilët punon, në realizimin e aktiviteteve lidhur me ndërtimin e paqes. Qëllimi përfundimtar i këtij procesi është që të inkuadrohet një metodologji e punës me nxënësit, specifike për temën e ndërtimit të paqes në arsimin formal.

Asociacioni i Mësimdhënësve të Historisë në Maqedoni

Asociacioni i Mësimdhënësve të Historisë në Maqedoni është organizatë jopartiake, jofitimprurëse dhe joqeveritare, për mbrojtjen, avancimin dhe zhvillimin e mësimdhënies së historisë në arsimin fillor dhe të mesëm në Republikën e Maqedonisë.

Misioni i AMHM është avancimi i bashkëpunimit të mësimdhënësve në vendin tonë, në fqinjësi dhe në planin ndërkombëtar, nëpërmjet këmbimit të informatave dhe ideve, pjesëmarrjes në konferenca ndërkombëtare, seminare, projekte...

Zhvillimi i paqes, demokracisë, stabilitetit dhe avancimi i marrëdhënieve ndëretnike në Republikën e Maqedonisë dhe në rajon.

Ideja themelore me të cilën udhëhiqeshin themeluesit e AMHM-së, e së cilës Asociacioni vazhdon t'i përmbahet, është që AMHM të veprojë si një organizatë e cila do t'i bashkojë mësimdhënësit e historisë në vend dhe do t'u ndihmojë në sendërtimin dhe përsosjen e tyre profesionale, mbi të gjitha.

Sidomos në situata kur pjesa më e madhe e mësimdhënësve për këtë nuk kanë kushte, ndërsa seminare dhe trajnime të specializuara për arsimtarë të historisë në vend nuk mbahen me vite me radhë. Për këto arsye, AMHM në pothuajse 20 vitet e kaluara të veprimtarisë arriti që ta animojë pjesën më të madhe të mësimdhënësve të historisë në vend, duke organizuar trajnime, seminare, konferenca dhe projekte të shumta, para së gjithash duke vepruar në mënyrë mbikombëtare, multietnike dhe në frymën e barazisë dhe mirëkuptimit të ndërsjellë.

Gjatë kësaj, një theks i veçantë vihet mbi avancimin e bashkëpunimit me mësimdhënësit e rajonit, madje edhe më gjerë, për të cilën gjë flasin edhe projektet e shumta ndërkombëtare në të cilat AMHM merr pjesë në mënyrë aktive. AMHM sot mundet me krenari të lëvdohet se e ka rjetin më të madh të mësimdhënësve të historisë në Maqedoni, nëpërmjet të cilit ka ofruar trajnime të shumta, të cilat në pjesën më të madhe i janë dedikuar zhvillimit të mendimit kritik, zbatimit të qasjes multiperspektive në

mësimdhënie dhe paraqet një lider të vërtetë në avancimin e modernizimit të mësimdhënies së historisë.

Njëkohësisht, në veprimtarinë e vet të deritanishme, AMHM ka përpiluar materiale dhe doracakë të shumtë mësimorë plotësues për mësimdhënësit të cilët rregullisht e gjejnë përdorimin e tyre në mësimdhënien e përditshme të historisë.

Vlen të përmendet edhe anëtarësimi i AMHM-së në EUROKLIO (Asociacioni i Mësimdhënësve të Historisë në Evropë), duke realizuar një kontribut të dukshëm në avancimin e mësimdhënies në rajon dhe më gjerë në Evropë. Për këtë sidomos dëshmon organizimi i Konferencës Vjetore të EUROKLIO-s për vitin 2014 në Ohër, me temë: "Historia jashtë kufijve", në të cilën morën pjesë 180 nxënës dhe 47 shtete nga Evropa dhe bota.

Fushat e veprimit janë:

- përpilimi dhe realizimi i projekteve, seminarëve, konferencave dhe punëtorive për mësimdhënësit e historisë
- bashkëpunimi me institucionet dhe organizatat e vendit dhe të huaja qeveritare dhe joqeveritare në fushën e avancimit dhe ngritjes së cilësisë së mësimdhënies së historisë dhe përshtatja ndaj rrjedhave bashkëkohore në Evropë dhe në botë
- publikimi i gazetës "Informator" për arsimtarët e historisë, faqja e internetit e Asociacionit etj.
- përpilimi i materialeve plotësuese të historisë (përmbledhje dokumentesh, harta historike, publikime multimediale etj.)
- ngritja e cilësisë së librave shkollorë dhe pajisjeve ndihmëse të historisë
- organizimi i garave të historisë për nxënësit.

Për projektin

Shoqata Aksioni Paqësor dhe Asociacioni i Mësimdhënësve të Historisë në Maqedoni e realizojnë projektin “Interpretimi i historisë së përbashkët të kohës bashkëkohore”. Ky projekt është një iniciativë 12-mujore, e cila filloi në qershor të vitit 2020, qëllimi i të cilit është: Partneritete të ndërtuara për paqe dhe arsim.

Realizimi i këtij projekti hap një dialog konstruktiv ndërmjet arsimtarëve të historisë të shkollave fillore dhe të mesme në vend, i cili do të vihet në funksion për krijimin e rekomandimeve për përpilimin e programit mësimor për këtë lëndë, në të cilën do të përfshihen dhe do të nxiten vlerat qytetare të nxënësit.

Aksioni Paqësor dhe AMHM do të punojnë mbi iniciativën për ndryshimin e perceptcionit për interkulturalizëm, nëpërmjet lëndës së historisë në shkolla.

Vlerësojmë se kjo lëndë është kyçe kur bëhet fjalë për ndërtimin e paqes, uljen dhe çrrënjosjen e stereotipave dhe paragjytimeve për “tjetrin”, por edhe nevojë për një dialog të hapur ndërmjet shtresës profesionale për interpretimin e historisë nga gjysma e dytë e shekullit XX dhe në fillim të shekullit XXI.

Me realizimin e këtij projekti, Aksioni Paqësor dhe AMHM e përforcuan partneritetin e ndërsjellë, ndërsa me vetë këtë edhe angazhimin e tyre qytetar, pjesëmarrjen dhe hapjen ndaj kontribuesve të vet, por edhe ndaj shoqërisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe sektorin qytetar.

Angazhimi ynë përfundimtarë është që t'i promovojmë politikën për ndërtimin e paqes dhe kulturës së kujtesës mes shoqatave qytetare, institucioneve arsimore dhe të tjera relevante të vendit.

Biografite

Bashkautorë:

Prof. dr. Katerina Todoroska

Dr. Katerina Todoroska ka lindur në vitin 1963 në Prilep, ndërsa nga viti 1969 jeton në Shkup. Arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë i ka kryer në Shkup.

Katerina Todoroska shfaq interes për punën shkencore dhe menjëherë pas kryerjes së studimeve të historisë në Fakultetin Filozovik e vazhdon shkollimin e studimeve pasuniversitare në të njëjtin fakultet.

Në vitin 1987 punësohet në Institutin Kombëtar të Historisë si asistente e re në Njësinë për Lëvizjen Rilindase dhe Çlirimtare Kombëtare dhe fillon me publikimin e punimeve të veta të para në revista shkencore.

Më 27 mars 1991 i përfundon studimet pasuniversitare me mbrojtjen e punimit të magjistraturës “Lidhjet maqedonase-shqiptare 1878-1903” në Fakultetin Filozofik në Shkup.

Më 22.02.2000 e mbron disertacioni e doktoraturës me titull “Raportet maqedonase-shqiptare 1903-1913 – çështja e shtetësisë dhe autonomisë së Maqedonisë dhe Shqipërisë” në Fakultetin Juridik në Shkup.

Në periudhën prej vitit 1993 deri në vitin 1994 ka qenë sekretare e Lidhjes së Shoqatave të Historianëve të Republikës së Maqedonisë, ndërsa nga viti 1995 deri në vitin 1997 edhe kryetare e këtij asociacioni, me emrin e ndryshuar Lidhja e Historianëve të Republikës së Maqedonisë.

Ka marrë pjesë në tubime shkencore me punime të vetat, të cilat janë publikuar në botime të ndryshme.

Që nga punësimi, dr. Todoroska përcaktohet për një temë pamjaftueshëm të përpunuar në historiografinë maqedonase, për lidhjet maqedonase-shqiptare, relacionet, kontaktet gjatë historisë.

Gjatë punës së vet, krahas aktiviteteve të tjera, është angazhuar edhe si anëtare e redaksive të publikimeve shkencore (“Historia”, revistë e Lidhjes së Historianëve të RM-së, “Glasnik” të Institutit për Histori Kombëtare (IHN), ndërsa në vitin 2012 edhe në “Prace komisji Środkowoeuropejskiej pau” të Akademisë së Arteve të Polonisë – Njësia Historike-Filozofike etj.), redaktore dhe regjisore e serialeve televizive.

Pas hapjes së studimeve pasuniversitare në kuadër të IHN, ligjëron më shumë lëndë dhe ka qenë mentore e shumë magjistrantëve dhe doktorantëve.

Si kryetare e Këshillit të IKP IHN nga korriku i vitit 2014 ka marrë pjesë në përgatitjen dhe sjelljen e më shumë dokumenteve interne, me të cilat është rregulluar puna e IKP IHN.

Në tetor 2014 zgjidhet anëtare e Senatit të Universitetit Shën Cirili dhe Metodi, deri në vitin 2016.

Gjatë punës së saj, ka publikuar mbi 200 punime dhe 15 libra (monografi dhe përmbledhe të dokumenteve), ndërsa ka marrë pjesë në më shumë se 100 tubime shkencore dhe konferenca etj.

Gjithashtu, shfaqet si mentore e mbi 30 magjistrantëve dhe doktorantëve në studimet e magjistraturës dhe doktoraturës në IHN dhe në Universitetin Shën Cirili dhe Metodi, ka qenë anëtare e komisioneve për mbrojtjen e punimeve të magjistraturës dhe doktoraturës të rreth 60 kandidatëve.

Doc. dr. Zejni Mazllami

Doc. dr. Zejni Mazllami ka lindur më 27.09.1987 në fshatin Gurgurnicë – Tetovë.

Studimet universitare i ka kryer në Universitetin Shtetëror të Tetovës në vitin 2010, në Fakultetin Filozofik, në programin studimor të Historisë.

Studimet e magjistraturës i ka vazhduar në Universitetin Shtetëror të Tetovës, në Fakultetin Filozofik, në programin studimor të Historisë, drejtimi Historia e Shekullit të Ri, me punimin e magjistraturës “Politika bullgare ndaj çështjes maqedonase 1903-1913”.

Studimet e doktoraturës i ka regjistruar në vitin akademik 2014/2015 në Universitetin Shën Cirili dhe Metodi, në Institutin për Histori Kombëtare.

Ka doktoruar më 29.07.2019 me disertacionin e doktoraturës me

titull “Qendrat dhe institucionet edukative të shqiptarëve në Maqedoni 1878-1912”.

Nga shtatori 2015 është angazhuar si bashkëpunëtor-asistent në Universitetin e Tetovës, Fakulteti Filozofik.

Dr. Zejni Mazllami ka marrë pjesë në shumë konferenca, simpoziume, seminare shkencore, shkolla verore dhe kurse të ndryshme në Maqedoni, Kosovë, Shqipëri, Bosnjë e Hercegovinë, Turqi dhe Izrael.

Është autor i librave “Fletorja e historisë” (2020), “Institucionet edukative të popullatës myslimane në Maqedoni 1878-1912” (2021), si edhe i shumë shkrimeve nga fusha e historisë dhe kulturës në shtypin periodik dhe ditor.

Ekipi i trajnerëve

Mire Mladenovski

(mire.mladenovski[at]gmail.com)

Mire Mladenovski është arsimtar i historisë, me 28 vjet përvojë pune. U ligjëron nxënësve të moshës prej 10 deri në 15 vjet. Ka përvojë në fushën e të shprehurit publik, organizimin dhe realizimin e seminareve dhe trajnimeve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Ka qenë i përfshirë si ekspert në shumë organizata ndërkombëtare dhe ndërqeveritare, duke përfshirë Këshillin e Evropës, në më shumë se 20 vende, kryesisht evropiane. Kryetar i AMHM, Kryetar i EUROCLIO (Asociacioni Evropian i Mësimdhënësve të Historisë) në periudhën 2018-2019, autor dhe redaktor i më shumë publikimeve nga fusha e historisë dhe arsimit. Ligjërues dhe realizues i shumë ligjëratave, punëtorive, trajnimeve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Goran Taleski

(goran.taleski[at]mirovnaakcija.org)

Goran Taleski ka lindur më 17.11.1976 në Prilep. Një nga themeluesit e Aksionit Paqësor. Është i angazhuar në punën e Shoqatës që nga fillimet e saj. Ka punuar në projekte nga fusha e ballafaqimit me të kaluarën, arsimit të integruar, njohjes dhe reagimit ndaj dukurive të diskriminimit, kundërshtimit të ndërgjegjes. Trajner për ndërtimin e paqes me përvojë shumëvjeçare. Punon si trajner i programeve me veteranë ushtarak dhe me mbledhësit e rrëfimeve jetësore.

Emrah Rexhepi

(emrah[at]mirovnaakcija.org)

Emrah Rexhepi është punëtor paqësor në Aksionin Paqësor. Ka studiuar Gjuhën angleze dhe studimet amerikane dhe Marrëdhëniet me publikun, që të dyja me fokus në politikën, jodhunën, multikulturalizmin dhe komunikimin në Universitetin Ndërkombëtar Ballkanik në Shkup. Është aktivist që nga mosha 7-vjeçare, duke marrë pjesë në mënyrë aktive në lëvizje dhe iniciativa të ndryshme lidhur me të drejtat arsimore dhe të drejtat e njeriut dhe ato sociale. Punon mbi arsimin e integruar dhe ballafaqimin me të kaluarën. Gjithashtu është edhe trajner për ndërtimin e paqes dhe ballafaqimin me të kaluarën.

Më parë është marrë me marrëdhënie me publikun dhe me gazetari.

Boro Kitanoski

(boro[at]mirovnaakcija.org)

I lindur në vitin 1976 në Prilep. Një nga themeluesit e Aksionit Paqësor në vitin 2001. Kundërshtues i ndërgjegjes. Ka përvojë shumëvjeçare si trajner në fushat: aksioni jo i dhunshëm, ndërtimi i paqes, historia gojore, arsimi paqësor, punë me veteranë luftime, kundërshtimi i ndërgjegjes dhe trajner për qasjen Do No Harm. Ka punuar në pozita të ndryshme në më shumë programe kombëtare, rajonale (ballkanike) dhe ndërkombëtare për antimilitarizëm, kundërshtim të ndërgjegjes, ndërtim të paqes, antidiskriminim, arsim paqësor, ndërsa tani është punëtor paqësor i Programit për Ballafaqim me të Kaluarën në Aksionin Paqësor.

Ka qenë anëtar i Komitetit Ekzekutiv të War Resisters' International – WRI (2006 – 2010) dhe anëtar i zgjedhur ndërkombëtarisht në Këshillin e WRI (2006-2014). Ka qenë koordinator kombëtar i Iniciativës REKOM (2010-2011) për Maqedoninë.

Aneks 1

Shqyrtimi i gabimeve të caktuara në librat shkollorë të historisë të arsimit fillor dhe të mesëm. Prof. dr. Katerina Todoroska, doc. dr. Zejni Mazllami

Libra shkollorë të arsimit fillor

Duke pasur parasysh faktin se në një periudhë të caktuar në Republikën e Maqedonisë përdorshin disa libra shkollorë për arsimin fillor dhe të mesëm, ne i përdorëm librat më të përdorur në shkolla, sepse pikërisht këta libra i kanë vlerësuar vetë mësimmshënësist, edhe pse me vërejtje, si më të pranueshëm për nxënësist. Thëksojmë se në periudhën kur janë përgatitur dhe shtypur këta libra shkollorë, në Republikën e Maqedonisë ka pasur shkollë fillore tetëvjeçare, kështu që me fillimin e zbatimit të nëntëvjeçares, librat zhvendosen për një klasë përpara. Në fakt, libri shkollor për klasë të pestë përdoret për klasën e gjashtë, e kështu me radhë¹¹.

Në këtë drejtim, u analizuan librat shkollorë për arsimin fillor, të cilat do t'i shkruajmë sipas reformës së re arsimore, nga klasa VI deri në klasën IX, si në vijim:

Libri shkollor për klasën VI, i autorëve Kosta Axhievski, Darinka Petreska, Vanço Gjorgjiev, Violeta Açkoska, Vojislav Sarakinski, i vitit 2005 – botues Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Në këtë libër shkollor ka mësim të panevojshme, të cilat përsëriten dy herë si njësi mësimshënëse. Gjeggjësist, mësimi "Qytetërimet më të vjetra" dhe "Shteti i vjetër egjiptian" përmbajnë të dhëna identike, gjë që është e panevojshme dhe e paarsyeshme për nxënësist, sepse s'ka nevojë për mësimin e të dhënave të njëjta dy herë në një njësi mësimshënëse. Në vend të kësaj, mund të

11. Ministria e Arsimit dhe Shkencës; Byroja për Zhvillim të Arsimit; Arsimi fillor – mësimi lëndor. Programet mësimore të historisë për klasët V – VIII, Shkup, 2004

shtohet një mësim tjetër, për shembull për Mesopotaminë apo për Indinë dhe për Kinën, në po të njëjtën periudhë. Në temën Helada përdoren disa terme të reja, si Ajolët, ndërsa duhet Eolët (fq. 39); Periojkët në vend Periekët; Hejlotët, duhet Helotët (fq. 41); Klejsten – Klisten (fq. 44); Ajs-hili – Eskili (fq. 46).

Mbi temën Maqedonia në shekullin e vjetër nuk është shpjeguar, as nuk është shkruar kuptimi i emrit Maqedoni (Makos – e madhe, Don – vend). Gjithashtu, problematik është edhe riemërtimi i termeve të caktuara të standardizuara, si Darej, duhet Darij (fq. 63); Babilon - maqedonisht duhet Vavilon (fq. 65.); Gaj Julie Kajser – Gaj Jul Cezar (maqedonisht) (fq. 77); Ajneida – Eneida (fq. 81); Kikeron – Ciceron (fq. 91); Takit – Tacit (fq. 83).

Në librin shkollor shkruan se dardanët kanë qenë të afërt me ilirët, ndërsa nuk është thënë se dardanët janë një nga fiset ilire.

Libri shkollor për klasën VII i autorëve Nenad Naneski dhe Behar Mehmeti, i vitit 2005, nga botuesi KAT Produkcija¹².

Te tema “Bota dhe Evropa në mesjetën e hershme” në njësinë mësimore “Karakteristikat e përgjithshme të mesjetës” janë paraqitur të dhëna të panevojshme, ndërsa nuk është dhënë shpjegimi për kalimin nga skllavëria në feudalizëm, si një karakteristikë e rëndësishme e mesjetës. Në këtë libër shkollor është evidente se autorët nuk janë udhëhequr nga Programi Mësimor i vitit 2004, kështu që njësitë mësimore nuk janë përpunuar. Kështu, për shembull, në temën “Ballkani dhe Maqedonia nën sundimin osman” mungojnë mësimet “Kultura në Maqedoni nga shekulli XV deri në shekullin XVII” dhe “Kultura e shqiptarëve nga shekulli XV deri në shekullin XVII”, edhe pse në planin dhe programin mësimor me të cilin duhet të udhëhiqen mësimdhënësitato janë të pranishme.

Libri shkollor për klasën VIII i autorëve Violeta Açkoska, Vanço Gjeorgiev, Fejzulla Shabani, Dalibor Jovanovski, i vitit 2005, nga botuesi Tabernakul.

12. Konsiderojmë se duhet ta japim edhe këtë informatë, se ka edhe një libër shkollor nga autorët Millan Boshkovski, Nebi Dervishi, Jordan Ilioski, i vitit 2005, i cili është shkruar në stil më të lartë, me shumë tekst, tepër shumë të dhëna dhe informata të parëndësishme për moshën e nxënësve 12-vjeçarë. Shumica e mësimdhënësve të konsultuar nuk e preferojnë.

Këtu ekzistojnë tema për historinë botërore, historinë evropiane dhe një temë voluminoze “Ballkani dhe Maqedonia nga shekulli XVIII deri te Lufta e Parë Botërore”. Duke e analizuar atë që është shkruar, mund të thuhet se libri shkollor është shkruar në stil të lartë, ngjarjet historike janë keq të shpjeguara, ndërsa përdoret edhe një terminologji shumë e panjohur dhe e palidhur. Herë-herë hasim vetëm fakte të hedhura pa ndonjë lidhje me tekstin e mëparshëm, sa u përket ngjarjeve më të rëndësishme, siç janë Luftërat Ballkanike. Krahas faktit që në Programin mësimor të vitit 2004 për Kryengritjen e Ilindenit parashihen edhe mjete të dukshme, nuk paraqitet asnjë hartë për t’u parë territori i Maqedonisë në atë periudhë, as nuk tregohet se ku ka qenë qendra, kur dhe ku është përhapur Kryengritja e Ilindenit. Në këtë mënyrë nxënësit janë të hutuar kur në mësim flitet për qarqe revolucionare, ndërsa ata nuk kanë mundësi ta përcaktojnë as Qarkun Revolucionar të Manastirit, ku ka nisur dhe është shuar Kryengritja e Ilindenit.

Në këtë libër shkollor më shumë vihet theksi tek analiza e shteteve të Ballkanit, veças, sesa te historia kombëtare.

Libri shkollor për klasën XIX, i autorëve Gjorgji Pavlovski, Dimka Ristovska, Vllado Vellkovski, Arian Alidemi, Halid Seidi, i vitit 2005, nga botuesi Prosvetno Dello.

Edhe ky libër shkollor ka shumë terminologji të panjohur për nxënësit, është analizuar një periudhë e madhe, ajo nga Lufta e Parë Botërore, periudha mes dy luftërave botërore, Lufta e Dytë Botërore dhe periudha pas saj, deri në vitet e 90-ta të shekullit XX. Vetë fakti që tërësitë tematike u dedikohen, si Maqedonisë, ashtu edhe vendeve tjera ballkanike dhe të botës, flet mjaft për stërngarkimin me informata, pa ndonjë racionalizim. Libri shkollor përmban tepër shumë fakte dhe të dhëna. Në tërë tekstin s’ka asgjë për Lëvizjen e vendeve të painkuadruara, edhe pse kjo lëvizje ka një efekt të konsiderueshëm mbi shtetin maqedonas si njësi federale e ish-federatës jugosllave. Gjithashtu të varfra janë informatat për Bashkimin Evropian dhe neokolonializmin. Në temën Lufta e Parë Botërore, pa nevojë përpunohen katër njësi mësimore të cilat kanë përmbajtje të njëjtë. Këto janë mësimet për vendet ballkanike, Maqedoninë dhe Shqipërinë në Luftën e Parë Botërore, që mund të përpunohen në një tërësi tematike.

Libra shkollorë për arsimin e mesëm

Sa u përket librave shkollorë të arsimit të mesëm, është bërë një analizë e teksteve vijuese:

Libri shkollor për vitin e parë të arsimit të mesëm (botimi i katërt) nga Millan Boshkoski, Nebi Dervishi, Safet Neziri, Dime Maxhovski, Sasho Nikolloski, i vitit 2016, nga botuesi Prosvetno Dello.

Ky tekst në librin shkollor është shkruar me një stil të lartë, të pakuptueshëm për nxënësit. Temat të cilat përpunohen përsëriten me temat nga librat shkollorë me të cilët mësohet në klasën VI të shkollës fillore. Në këtë mënyrë, nxënësit as nuk mësojnë diçka të re, e as teksti i shkruar nuk është i përshtatur për moshat e tyre. Në librat e historisë për vitin e parë të arsimit të mesëm, linkestët dhe enkelejtët paraqiten si fise antike magedonase, ndërsa në po këtë libër ka një njësi mësimore me titull Mbretëria ilire e enkelejtëve.

Në librin e historisë për vitin e parë të arsimit të mesëm shkruan se libri i shenjtë i myslimanëve, Kurani, përbëhet nga fjalët e profetit Muhamed. Kjo është fyese për ndjenjat e pjesëtarëve të fesë islame.

Libri shkollor është përplot me faktografi, që është e vështirë për memorizim dhe ekspikim nga ana e nxënësve. Me tekstin ofrohen elemente vizuale, por shpeshherë takohen gjëra joadekuate në përkrahjen vizuale të tekstit. Në fund të librit gjendet “Fjalori i fjalëve të panjohura”, por edhe në të ka gjëra të pasakta dhe terme pamjaftueshëm të shpjeguara. Për shembull, termi “totemizëm” shpjegohet si “besim i fisit në prejardhjen e përbashkët nga disa kafshë”, ndërsa gjatë kësaj nuk merret parasysh se totemi mund të jetë edhe një send.

Libri shkollor për vitin e dytë të arsimit të mesëm (botimi i tretë) nga autorët Millan Boshkoski, Nebi Dervishi, Sillvana Sidorovska-Çupovska, Natash Kotllar, Jordan Ilioski, Dimko Popovski, i vitit 2018, i botuesit Prosvetno Dello.

Ashtu si libri shkollor për vitin e parë, edhe ky përmban në mënyrë të njëjtë përmbajtje si libri shkollor i klasës VII, me atë që autorët kanë qenë më ambiciozë që ky tekst të jetë më voluminoz. Me këtë vetëm kanë bërë një tekst më të pakuptueshëm dhe të papërshtatshëm për nxënësit. Që në fillim të tekstit, ku flitet për

dukjen e qyteteve mesjetare, ofrohen paraqitje vizuale të Krakovit dhe Dubrovnikut, të cilat janë në tërësi të panatyrshme dhe të papërshtatshme. Gjegjesisht, nën fotografinë e Dubrovnikut shkuran "Dubrovniku para tërmetit të vitit 1667", ndërsa teksti ka të bëjë me shekullin XII dhe XIII.

Gjatë gjithë tekstit është krejtësisht e paqartë njësia tematike "Ballkani në mesjetën e zhvilluar", në të cilën në mënyrë konfuze hidhen informata për vendet ballkanike dhe për Bizantin nga shekulli XII deri në mesin e shekullit XV, në mënyrë që pastaj me të njëjtat të dhëna të zbërthehen gjendjet në "Principatën shqiptare nga shekulli XI deri në shekullin XIII", "Shtetin osman", "Principatën shqiptare në shekullin XV dhe rënien nën pushtetin osman".

Libri shkollor është përplot me materiale vizuale, të cilat shpeshherë nuk përputhen as me tekstet, as me periudhën kohore e cila përpunohen në një kornizë të caktuar tematike.

Libri shkollor për vitin e tretë të arsimit të mesëm (lëndë e obligueshme), botimi i katërt, nga autorët Novica Veljanovski, Gordana Pletvarska, Sonja Cvetkovska, Shiqeri Xhaferi, i vitit 2011, i botuesit Prosvetno Dello.

Krahas vijës së përbashkët të të gjithë librave shkollorë për arsim të mesëm, me përputhjen e temave me ato që mësohen në klasën e tetë në shkollat fillore, ky libër shkollor është interesant për shumë gjëra. Që në fillim paralajmërohet tërësia mësimdhënëse "Bota, Evropa dhe Ballkani në Luftën e Parë Botërore", që vetvetiu është një temë e papranueshme për nga gjerësia për përpunim. Por, mësimi i parë ka të bëjë me "Evropën në fillim të shekullit XX", në të cilin flitet edhe për SHBA-të dhe për shtete të tjera joevrpiane, duke futur konfuzion të nxënësit për atë se a mësohen dhe si mësohen shtetet joevrpiane në një kontekst të papërshtatshëm. Sipas nesh, ky libër mësimor është i stërngarkuar me të dhëna të panevojshme të cilat vetëm janë hedhur dhe izoluar nga konteksti, nxisin ndjenjën e ngarkimit të panevojshëm të nxënësit. Për shembull: "...Shpikjet më të rëndësishme shkencore-teknike nga kjo periudhë kanë qenë: në komunikacion, automobili i parë me motor me benzinë i Gotlib Dajmleerit dhe Karl Benzit (1887-1889); anija transoqeanike (fillimi i shekullit XX); aeroplani dykrahësh i vëllezërve Rajt (1903); anijet bartëse të aeroplanëve (1911); në shkencë, llamba elektrike e Edisonit (1879); vaksina kundër tërbimit të Pasterit (1885)...". Fjalja vazhdon. Hedhja e këtillë e emrave dhe viteve, pa ndonjë bazë as epilog të ngjarjeve, praktikohet gjatë tërë tekstit në këtë libër

shkollor. Baza vizuale e tekstit është e pranishme edhe në këtë libër shkollor, edhe pse ajo shpeshherë është imponuese dhe e papërshtatshme me tekstin.

Libri shkollor për vitin e katërt të arsimit të mesëm për drejtimin shoqëror-humanistik, i autorëve Darinka Petreska, Violeta Ačkoska, Margarita Peshevska, nga botuesi Tabernakul.

Analiza e këtij libri shkollor tregoi se në të i takojmë të njëjtat karakteristika si dhe për të mëparshmit. Ky libër shkollor është i ngarkuar me të dhëna të shumta dhe emra të cilët në mënyrë të pamjaftueshme ose fare nuk janë shpjeguar, ndërsa vokabulari i përdorur është i një niveli të lartë, të pakuptueshëm për nxënësit. Për shkak të kësaj, jo rrallë profesorët i thjeshtësojnë njësitë mësimore ose në mënyrë plotësuese e shpjegojnë tekstin e ofruar.

Libri shkollor për vitin e parë të arsimit të mesëm profesional, i autorëve Miroslav Boshkoviq, Dançe Maçevska, i vitit 2010, botim i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Maqedonisë.

Për dallim nga librat tjerë shkollorë për arsimin e mesëm, ky libër është përpiluar nga autorë të cilët kanë një përvojë shumëvjeçare në praksë, që ka kontribuar për një gjuhë më të përshtatshme dhe të kuptueshme në tekstet. Në libër përpunohen tema nga koha më e lashtë deri te periudha pas Luftës së Dytë Botërore. Duke pasur parasysh vëllimin e materialit, autorët në çdo mësim i kanë përcjellë të dhënat themelore për njësitë tematike. Kjo, në anën tjetër, ka krijuar problem në eksplikacionin, i cili është shumë i ngjeshur me faktografi të vështirë për t'u mbajtur mend nga nxënësit. Ajo që vërehet për këtë libër shkollor është prania adekuate e materialit vizual dhe saktësia e pyetjeve të dedikuara për nxënësit. Gjithashtu, në këtë libër vërehen tema interesante nga kultura urbane botërore, që gjithsesi paraqet një freski krahasuar me librat tjerë shkollorë.

Historia e Maqedonisë për vitin e dytë të arsimit të mesëm profesional, i autorëve Miroslav Boshkoviq, Dançe Maçevska, i vitit 2010, botim i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Maqedonisë.

Si autorë të këtij libri paraqiten të njëjtët persona si edhe në librin shkollor të mëparshëm dedikuar shkollave të mesme profesionale.

Në të janë përfshirë më shumë tema, siç është “Maqedonia në antikë”, “Maqedonia në mesjetë”, “Maqedonia nën sundimin osman (nga mesi i shekullit XIX)”, “Lufta Çlirimtare Kombëtare e popullit maqedonas në Luftërat Ballkanike” dhe “Maqedonia nga Luftërat Ballkanike deri te pavarësia”. Libri i koncipuar në këtë mënyrë ka të bëjë me një periudhë shumë të gjatë, që ka rezultuar me një tekst i cili është i ngarkuar me faktografi, ngjarje të cilat në mënyrë të pamjaftueshme apo fare nuk janë shpjeguar, emra të personave të cilët më parë nuk takohen dhe nuk janë në korrelacion me të dhënat e mëparshme. Ky libër shkollor është i mbushur me një përkrahje të përshtatshme vizuale, e cila ndihmon në shpjegimin plotësues në tekst. Gjithashtu, për nxënësit parashtrihen pyetje adekuate dhe detyra plotësuese.

Aneks 2

Pyetësor për projektin “Interpretimi i historisë së përbashkët në kohën bashkëkohore”

1. A mendoni se tekstet shkollore të historisë janë me koncept dhe përmbajtje të vjetëruar?
2. A keni hasur ndonjë lëshim/e në tekstet mësimore? Nëse po, a keni reaguar lidhur me të dhe cilat kanë qenë rezultatet?
3. Gjatë mësimdhënies a e keni respektuar në përpikmëri planprogramin mësimor apo keni bërë modifikime të caktuara për të cilat keni vlerësuar se janë të nevojshme?
4. Cila ëshë qasja Juaj ndaj nxënësve gjatë ligjërimit dhe sqarimit të termave vijues: identiteti kombëtar, popull autokton, shpërngulja e fiseve?
5. Sipas mendimit Tuaj, në tekstet shkollore të historisë, a ju jepet me shumë rëndësi dhe hapësirë ngajrjeve të caktuara nga jeta politike se sa bashkëjetesës në shoqëritë shumë etnike dhe shumë religjioze?
6. Tekstet shkollore të historisë në Maqedoninë e Veriut a duhet të vazhdojnë të jenë me tematika të ndara (historia e popullit maqedonas, historia e shqiptarëve, etj) apo duhet të jenë të përbashkëta (historia e Maqedonisë së Veriut)?
7. A duhet të ballafaqohemi apo tju shmangemi temave “problematike”?
8. Si duhen vlerësuar ngjarjet e vitit 2001 dhe a duhet të jenë pjesë e planprogramit mësimor?
9. Si historianë a Ju shqetëson shfrytëzimi dhe interpretimi i gabuar i figurave dhe ngjarjeve historike për interesa të politikës ditore?
10. Projektet, punëtoritë dhe angazhimi Juaj jashtë mësimi a Ju ndihmon të krijoni interpretim me të gjerë e me të ndryshëm të temave historike?

